



Cikli i dytë i studimeve (pasdiplomike)

Tema

**Pozita e personave të dënuar gjat qëndrimit në burgun e Tetovës për vitet
2007/2014**

Kandidati:
Lindita Shabni

Menotr: Dr.Sc. Besa Arifi

Tetovë , 2019

HYRJE

KAPITULLI I

1. Dënimi me burgim, roli dhe rëndësia e tij
 - 1.1.Zanafilla e dënimit me burgim
 - 1.1.1.Faktorët që determinuar paraqitjen e burgjeve të para në botë
 - 1.1.2.Formacionet e para të dënimit me burgim
 1. 1. 3.Llojet e dënimeve para paraqitjes së dënimit me burgim
 - 1.2.Sistemet dhe llojet dënimit me burgim
 - 1.2.1.Sistemi kolektiv
 - 1.2.2.Sistemi i qelisë
 - 1.2.3.Sistemi i heshtjes
 - 1.2.4.Sistemi progresiv
 - 1.2.5.Sistemi klasifikimit
 - 1.2.6.Sistemi modern
 - 1.3.Psikologjia e burgut
 - 1.3.1.Qëllimi i burgut
 - 1.3.2.Të drejtat e njeriut
 - 1.3.3.Kuptimi psikologjik i burgut
 - 1.3.4.Kufizimi i lirisë

KAPITULLI II

- 1.1.Mënyra e ekzekutimit të dënimit me burgim
- 1.2.Trajtimi i personave të dënuar
 - 1.2.1.Klasifikimi i institucioneve korektuese
 - 1.2.2.Ndarja dhe kategorimizimi i personave të dënuar
- 1.3.Tretmani i të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit

KAPITULLI I III

- 1.1.Historiku idhe baza juridike e organizimit të institucioneve penitensiare në Republikën e Maqedonisë
- 1.2. Organizimi dhe gjendja e institucioneve penitensiare në Republikën e Maqedonisë

- 1.2.1. Enti ndëshkues përmisues i Idrizovës me repart të hapur në Veles.
- 1.2.2. Enti ndëshkues përmisues i tipit të hapur në Strugë.
- 1.2.3. Burgu i manastirit me paralele në Prilep
- 1.2.4. Burgu i Shtipit me paraele në Strumic
- 1.2.5. Burgu u Shkupit me paralele në Krivapallank
- 1.2.6. Burgu i Gjevgjelisë
- 1.2.7. Burgu i Ohrit
- 1.2.8. Burgu i Tetovës
- 1.3.Parimet kryesore të organizimit të institucioneve penitensiare
 - 1.3.1.Parimi i ligjshmërisë
 - 1.3.2.Parimi i humanitetit
 - 1.3.3.Parimi i mbajtjes kolektive të dënimit me burgim
 - 1.3.4.Parimi i individualizimit
 - 1.3.5.Parimi i ndalimit të keqtrajtimit dhe parimi i ndihmës postpenale

KAPITULLI IV

- 1.1. Struktura e organizimit të burgut të Tetovës
 - 1.1.1. Drejtori i institucionit penitensiar
 - 1.1.2. Sektor i pavaruar për punë të përgjithshme juridike
 - 1.1.3. Sektor i sigurimit
 - 1.1.4. Plani i sigurimit në Burgun e Tetovës
 - 1.1.5. Mënyra se si i kryejnë punët në sektorin e sigurimit
- 1.2. Mënyra e pranimit të të burgosurve
 - 1.2.1. Dobësit e funksionimit të zyrave të pranimit
- 1.3. Vendosja e personave të dënuar
 - 1.3.1. Të drejtat e personave të dënuar
- 1.3.Të dhënat mbi numrin, moshën dhe gjininë e të burgosurve nga viti 2007-2014 në Tetovë
- 1.4. Gjendja e burgut të Tetovës
- 1.5. Reformat e nevojshme në burgun e Tetovës

PËRFUNDIM

HYRJE

Arsyeja pse është zgjedhur pikërisht kjo temë për hulumtim është se çdo ditë hasim lajme për pozitën e personave nëpër burgje dhe ankesat e tyre lidhur me kushtet në të cilat ato i vuajnë dënimet. Që të merren informata më të hollësishme rreth kësaj problematike është bërë vizitë me qëllim hulumtues në burgun e Tetovës që të shihen për së afërmi kushtet në të cilët të burgosurit i vuajnë dënimet me burg. Kjo vizitë është kryer në burgun e Tetovës në periudhën kohore prej tre ditësh gjatë të cilave kam pasur rastin që të shohë për së afërmi burgun në të cilin ishte shumë vështirë që të depërtohej edhe më e vështirë ishte që të merreshin informata rreth punës që kryenin nëpunësit e atyshëm, ishte pothuajse e pamundshme që të shihen dokumentet dhe regjistri ku ishin të shënuar të gjithë të burgosurit, veprat e kryera dhe të gjitha të dhëna personale të të burgosurve aktual si dhe të dhënat për recedivistët më të shpeshtë. Gjithashtu informacione të rëndësishme përmbante edhe regjistri në të cilin shënoheshin veprat penale më të kryera në rajonin e Tetovës, niveli i arsimimit i personave që kryejnë më së shpeshti vepra penale, gjinia e kryerësve të veprave penale, vendbanimi i kryerësve, vendet e krimit, viktimat më të shpeshta dhe të dhëna të tjera të cilat m'u diktuan nga një nga nëpunësit sepse nuk ishte e lejuar që unë të kem qasje direkte te regjistri.

Rastësisht isha dëshmitare e rastit kur një i burgosur kishte nevojë për medikamente sepse po mjekohej nga varshmëria e narkotikëve dhe po kalonte një krizë nervore në atë moment dhe nëpunësit po bisedonin mes vete se nuk kishte qetësues për ti dhënë dhe se ndoshta dëshiron ti lajmërojë të afërmit që ti sjellin nga jashtë.

Kjo shumë qartë tregon se të burgosurit nuk vuajnë dënimet e tyre në kushte njerëzore dhe perms kësaj teme unë do të mundohem që të jap rekomandime rreth asaj se si mund të ndryshohet kjo gjendje dhe pse deri më tani nuk ka pasur përmirësime të kësaj situate.

Në kapitullin e parë do të filtet për dënimet para paraqitjes së dënimit me burgim.

Në kapitullin e dytë do të filtete për ekzekutimin e sanksioneve , kategorizimin e insitucioneve korektuese dhe tretmanin gjat vujatjes së dënimit.

Në kapitullin e tretë do të filitet për inistucioneet korektuese ne R.M.

Në kapitullin e katërt do të filitete për persoant e dënuar që vujanë dënimin e tyre në burgun e Tetovës dhe cilat janë kushtet aktuale.

1.Dënimi me burgim, roli dhe rëndësia e tij

Në strukturën e të gjitha llojeve të sanksioneve penale që njihen deri më tani në të drejtën penale bashkëkohore, dënimi me burgim është lloji më i vjetër i sanksionit penal. I cili ka lindur nga gjakmarja dhe kompozicioni, si forma të para të reagimit të shoqërisë ndaj veprave të ndaluara të individëve. Gjer në fund të shekullit XIX dënimi me burgim ka qenë i vetmi lloj i sanksionit penal. Përkundër faktit se tani të drejtat penale bashkëkohore njohin edhe lloje të tjera të sanksioneve penale, dënimi me burgim edhe sot është sanksion themelor ngase shqiptohet më së shpeshti ndaj kryerësve të veprave penale. Dënimi me burgim është mjet kryesor në luftën kundër kriminalitetit. Ushtrimi i represionit penal ka qenë një ndër atributet dhe funksionet e rëndësishme të shtetit, andaj baza juridike e dënimit konsiston në atë se në bazë të çkahit shteti ka të drejtë t'i dënoj kryerësit e veprave penale.¹

Shqiptimi i dënimit me burg është në ritje të madhe në shumë vënde të botës modern, poashtu edhe në vendin tone. Edhe pse dënimi me burgim, apo privimi nga lirija sado që të jetë në qendër të vëmëndjes nuk ka aritur qëllimit të cilët i janë imponuar, që d.m.th se nuk është në ulje kriminaliteti.

Qëllimet e dënimit sipas KPM janë dy më të rëndësishme: ndalimi i autorit të kryejë vepra penale dhe riedukimi i tij dhe ndikimi edukativ mbi të tjerat për të mos kryer vepra penale (neni 32 i KPM-së). Një ndër llojet e dënimeve të cilin e parashehë Kodi Penal i RM-së është dënimi me burg i cili bën pjesë në dënimet kryesore i cili mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesorë (neni 33 i KPM-së). Dënimi me burg zë vend kryesorë në sistemin e sanksioneve penale sipas prof. Ragip Halilit në veprën Penologjia, ku gjithashtu thekson se "burgosja dhe privimi nga liria i kryerësve të veprave penale dhe personave të tjerë që silleshin në mënyrë devijante, paraqitet shumë më herët se sa paraqitja formale e dënimit me burg. Paraqitja e burgjeve të para nuk përputhet me sanksionimin e dënimeve me burgim sepse këto paraqiten më vonë."²

Rëndësia e të gjithë sanksioneve penale poashtu edhe e dënimit me burg qëndron në atë se mundet të shqiptoj vetëm gjykata në procedurë të përcaktuar me ligj, dënim i cili godet vetëm kryerësit e

¹ I. Salihu :E drejta penale-Pjesa e përgjithshme ,Prishtinë ,2012 fq.421-425

²R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2014

veprave penale e cila konsiston në marjen apo kufizimin e të mirave të caktuara juridike, sic janë, liria, ndalimi i ushtrimit të profesionit,veprimtarisë,detyrës,apo funksionit etj.**Qëllimi i shqiptimit të dënimit me burgim qëndron në atë se në këtë mënyrë arihet mbrojtja e shoqërisë dhe qytetarëve nga kriminaliteti.**

Sipas literaturës bashkëkohore mbi qëllimin e ndëshkimit,dënimi ka për qëllim pengimin e veprimeve të rezikshme shoqërore dhe riedukimin e kryerësve të veprave penale që në të ardhmen mos të kryejnë veprime të tilla.Po ashtu,dënimi ka për qëllim që të ndikojë në mënyrë edukative që qytetarët e tjerë mos të kryejnë vepra penale.Gjithashtu tek dënimi më burgim, siç ishte më pare hakmarja ndaj kryerësve të veprave penale sot pothujaj se ky qëllimi është zbutur dhe si qëllim i fundit,zakonisht trajtohet riintegrimi i personave të dënuar dhe aftësimi i tyre që të kthehen në liri si qytetarëkorëktë dhe të kenë një jet normale ne ambient të caktuar shoqërorë. E gjithë kjo ndodh sespe është e pa mundur të arihet riintegrimi dhe riedukimi i vërtetë i kryerësve të veprave nëse ndaj tyre, në të njëjtën kohë aplikohet masa të shtërngimit dhe të frikësimit.

Në këtë drejtim është i njohur edhe mendimi i penologut të njohur francez P.Kornil, i cili thekson senë pikëpamje penologjike ëshë e pamundur që qëllimi i riedukimit dhe i frikësimit të arrihet në të njëjtën kohë.Përkundër nëse insistohet që ndaj kryerësve të veprave penale të arrihet edhe përmisimi edhe frikesimi ne të njëjtën kohë atëherë rezikohet që të mos arihet asnjëra nga këto qëllimet.³

1.1. Zanafilla e dënimit me burgim

Shqiptimi i dënimit me burgim si masë penalo-juridike e cila shqiptohet ndaj kryerësve të veprave penale ka një histori të gjatë,e paraqitur që në kohën e skllaverisë por atëherë nuk ka pasur karakterin e sanksioneve penale.Qëndrimi nëpër burgjet në kohën antike ka shërbyer si një vend ku i dyshuari ose dënuari ka pritur dënimin fizik,ekzekutimin,ose lirimin nga dënimi.Për funksionimin e e burgjeve tëatëhershme deklarohet gjithashtu edhe jurisiti i njohur Romak Ulpijani i cili thotë :''se burgjet duhet shërbyer vetëm si paraburgim jo edhe për tëndëshkuar''.Në të drejtën romake burgu është përdorur shpesh si masë e detyrueshme për mos pagimin e borxhit.Megjithatë dënimi privimi nga liria është përbërë në:

-dëbim në ishuj të caktuar

³R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, fq.61-63

-dhe punë në dobi të përgjithshme.

Në kuptim të vërtetë si sanksion penal dënimi privimi nga lirija është paraqitur për herë të parë në XIV, por në kuptim të vërtetë është paraqitur në shek. XVIII në KP. Francë në të cilën është kufizuar zbatimi i dënimit me vdekje dhe dënimet trupore, ku u shfuqizua dënimi me burg të përjetshëm dhe pranoi sistemin absolut të dënimeve të caktuara.⁴

Duke shikuar historikisht, llogaritete që burgjet të jenë paraqitur edhe para se të paraqitet dënimi me burgim, si lloj i dënimit. Burgjet e atëhershme janë konsideruar si vend izolimi për kryerësve të veprave penale dhe personat që janë llogaritur se kanë kryer sjellje devijante.

Burgjet janë njohur edhe nga shtete më të vjetra sic janë: Egjipti i vjetër, Mesopotamia, Asiria, Roma, Greqia e vjetër dhe disa shtete mesjetare. Kështu, p.sh., të dhënat më të hershme mbi burgjet në Egjipt datojnë që nga periudha e Mbretërisë së Mesme (2050-1786 para erës sonë).

Si zakonisht burgjet e atëhershme dallojnë shumë nga burgjet e sotme, për arsye se si burgje në ato kohra llogariteshin bodrumet e kalave "Qubliettes" ose të kështjellave të vjetra "Bastilles", me kushte tejet të vështira.

Kalajat ose bodrumet e atëhershme që llogariteshin si burgje ishin të mbushura me persona që llogariteshin se kanë kryer sjellje delikvente, dhe ishin të rezikshëm për shoqërinë.

Nga kjo vërejmë edhe se burgje e atëhershme kishin shumë dallim nga burgjet e sotme, për arsye se në ato kohra burgjet shërbenin si masë preventive ndaj kryerësve të veprave penale dhe ndaj atyre që kryejnë sjellje delikvente, me qëllim të sigurimit të prezencës së tyre dëri në pritjen e shqiptimit të dënimit kryesor ndaj tyre i cili ishte dënim më vdekje ose dënimet trupore.

Pra, burgjet e atëhershme llogariteshin si vende ku ruheshin kategorija e caktuar e delikuentëve deri tek shqiptimi apo ekzekutimi i tijë, prandaj në literaturë thuhet se gjyqëtarët e atëhershëm i zbraznin burgjet kurse në shtete bashkëkohore i mbushin burgjet.

Edhe gjatë mesjetës ishte e njëjta situatë nuk egzistonte dënim me heqje liri si lloj dënimi, burgjet e atëhershme më shumë shërbenin si masë preventive.

⁴http://ëëë.mojrad.net/pregled_teksta.php?id=6371LScCNBSëgai6LsE5dgnVLSccNBSëgai6LsE5dgnVe qasuar 02.04.2019

Gjatë shekujve XVI-XVII nëpër vendet e Evropës realizohet një lëvizje e madhe e popullatës nëpër relacione fshat qytet, ku me këtë rast bëhet grumbullimi i madh i popullsi në qytete. Pasojat e së cilës vërëhen tek njërzit e pa punë , bredhësve , lipsëvë, alkoolist , prosituteve, etj, situatë që parashihej edhe si rrezikë për ambientin shoqëror. Personat që bënë këto lëvizje llogariteshin si persona potencial që mereshin me veprime kriminale.

Duke pasur parasysh faktin se egzistonin këto lloj delikuentësh me veprime të ndryshme kriminale , në disa shtete të evropës filluan të themelohen edhe ente të vecanta për vendosjen e këtyre kategorive që ishin poashtu të detyruar të punojnë.

Insitutucion i parë i këtij lloji logaritete burgu ‘‘*Brideëell*’’ në Londër , që u themeluar në vitin 1553 nga mbreti Eduardi I VI, burg në të cilin në fillim ishin të vendosur peronat e papunë, lypsit, dhe bredhësit. Ku pas tyre fillau të mbushen dhe me kryrës të veprave penale dhe sjelljeve tjera delikumente me këtë rast ky burg llogaritete edhe burgu më i vjetër i tipit bashkëkohor.

Si ent tjetër përmendet edhe burgu për të mintur i Amsterdamit i cili ishte i këtij lloji, i themeluar ne vitin 1595 , ku më vonë u themelua edhe burgu për të femra , në të cilin burg vendoseshin prositutet dhe të tjera që ishin të dhë në pas jetës së shfrenuar.

Janë të njohura edhe burgje të tjera të Evropës si : burgu i Bremenit 1609, burgu i Hamburgut 1622 etj.

Burgjet e atëhrshme nuk kishin qëllimin, karakterin e dënimit, por ishin si një masë preventive e cila kishte disa qellime.

Më parë heqja e lirsë konisderohej si paraburgim ose burg hetuhes ku i gjithë qëllimi i kësaj ishte prezenca e të pandehurit deri në përfundimin e çështjes penale më sakt deri tek shqiptimi i dënimit kryesor dhe ekzekutimi i tije. Shpesh herë mund të paraqitej edhe si burg personal ku mbaheshin borxhlijtë të burgosur dri sa të kthenin borxhin ose nëse kishin ndonjë llogari ndaj shtetit. Pas ndryshimeve ekonomiko- shoqërore dhe depertimin të ideve humanitare me qëllim të luftimin të kriminalitetit, paraqitete dënimi i vërtetë me heqje lirije ose me burg , si lloj sanksioni penale.⁵

1.1.1.Faktorët që determinuan në paraqitjen e burgjeve të para në botë

⁵ R.Gashi: Ekzekutimi I dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë 2001 fq.11-14.

Duke pasur parasysh faktin se sistemi i dënimeve, gjatë kohës së vjetër dhe mesjetës, mbështetej tek dënimet trupore e fizike dhe dënime në të holla ose me gjobë. Dënime të cilat ishin në përputhje me botkuptimet dominuese mbi hakmarjen dhe gjakëmarjen si qëllim kryesorë të ndëshkimit. Edhe pse këto dënime shqiptoheshin për luftimin e kriminalitetit, mirëpo këto dënime nuk patën sukses.

Dënimet e tjera sic ishin dënimi me vdekje apo dënimet trupore patën kritika të shumta, sepse ishin dënime që shkaktonin vetëm vuajtje dhe mundime ndaj kryerësve të veprave penale, por nuk ndikuan pozitivisht ndaj pengimit të kriminalitetit.

Përshkak mundimeve të mëdha dhe torturave që shpreheshin ndaj të burgosurve dhe mos aritja e e qëllimeve të caktuara ndaj këtyre dënimeve filluan edhe kritika të ashpra prej asaj kohe, dhe duke paraqitur ide dhe mendime tjera për gjetjen dhe aplikimin e metodave tjera më efektive për luftimin e kriminalitetit.

Por ideja qëpërmes izolimit e në vecanti nëpërmjet angazhimit të persoanve delikuentë në punë u vlersua si mundësi e mirë për pengimin e kriminalitetit. Sipas prof. Ragip Halili ne veprën Penologjia ku thekson:

“Si faktorë që kontribuan në paraqitjen e dënimit me burgim janë:

1. Mendimet dhe idetë humaniste e përparimtare të filozofëve dhe shkollave të ndryshme;
2. Idetë dhe kontributi i Revolucionit francez dhe legjislacionit i tij penale dhe ndikimi i pranisë së lirive dhe te drejtave të qytetarëve si dhe

3. Shfrytëzimi i punës së persoanve të dënuar si fuqi e lirë puntore “⁶

1. Mendimet dhe idetë humaniste e përparimtare të filozofëve dhe shkollave të ndryshme Në lidhje me problematikën e kriminalitetit, e vecanarisht me veprimet ndëshkimore, dhe nevojën e ndryshimit të burgjeve paraqiten shumë herët, në punimet dhe veprat e filozofëve, si: T. Mor, H. Grocius, Xhon Huard etj. të cilët kanë kritikuar politikën dhe sistemin ndëshkimor dhe gjendjen e burgjeve në shoqërinë feudale e posacërisht ekzekutimin e dënimeve me vdekje, trupore fizike dhe llojet e tjera të ndëshkimeve degradues. Ku është propozuar që lloji i këtyre dënimeve barbare tëzëvendësohen me dënim me burgim. Ku si qëllim të vetëm kishin realizimin e kycjes në procesin

⁶R. Halili: Penologjia- vep, e cit. Fq.98

e punsimit ,me qëllim të përmismimit, dhe hakmarja mos të jetë si qëllim i vetëm i kryerësve të veprave penale. .I gjithë qëllimi i dënimit duhet të ndikojnë në përmisimin dhe riedukimit e tyre.⁷

2.Idetë dhe kontributi i Revolucionit francez dhe legjislacionit i tij penale dhe ndikimi i pranisë së lirive dhe te drejtave të qytetarëve

Në këtë fazë shifen ndryshime në aspektin juridik dhe shoqëror të së drejtës penale dhe sistemit ndëshkimor. Të rëndësishme e bënë këtë faze gjithashtu edhe nxjerja e shumë ligjeve të reja ku edhe dënimi me burgim parashihej si dënim kryesor që më parë si dënim kryesor shqiptohej dënimi me vdekje dhe dënimet trupore.Në këtë periudhë gjithashtu paraqiten parimet e njohura tëshkollave dhe lëvizjeve humaniste historiko-juridike, si p.sh:parimi i ligjshmërisë ,parim i barazisë qytetare para ligjit dhe parimet e tjera. Ishte fazë në të cilën reduktoheshin dënimet që cënonin lirt dhe të drejtat, ku dënimet cnjerëzore sic ishin dënimet trupore , dënimi me vdekje zëvendësohet me dënimin me burgim.⁸

3.Shfrytëzimi i punës së persoanve të dënuar si fuqi e lirë puntore

Ishte një shkak shumë i rëndësishem për paraqitjen e dënimit me burgim. Ishte periudh në të cilën pushteti kishte interes mos të aplikohen dënimi me vdekje dhe dënimet trupore , me qëllim që të egzistonte mundësia e shfrytëzimit të tyre në industry. Përgjat kycjes të të dënuarve në punë ato në një far mënyre bënin kompensimin e dëmit ndaj shoqërisë.

Por duhet të kemi parasysh faktin se edhe pse nuk ekzekutoheshin dënimet trupore apo denimet e renda fizike, denimi me vdekje gjithsesi të dënuarit ishin të obliguar që të punojnë punë të renda fizike dhe johumane. Gjithesi kjo dallohet si fazër e paraqitjes apo ekzekutimin të dënimit me burgim , dhe jo më dënimi me vdekje, apo dënime trupore.⁹

1.1.2 Formacionet e para të dënimit me burgim

⁷R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2014

⁸R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2014

⁹ R.Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, fq.99-100

Dënimi me heqeje të lirisë apo dënimi me burgim për herë të parë është paraqitur në Kodin Penal Francez të viti 1792. Kjo periudhë konsiderohet periudha e aplikimit të dënimit me burgim ndaj kryerësve të veprave penale dhe llogaritet si mjet për luftimin e kriminalitetit.¹⁰

Pas paraqitjes së dënimit me burgim në Kodin Penal të viti 1792 e posacërisht tek Kodi i Napoleonit, ky dënim gjeti përkrahje dhe filloj të parashikohet në shumë legjislacioni dhe tëparashikohet në shumë kode të Evropës dhe SHBA-ve.

Arsyeja se pse filloji të aplikohet më së shumiti dënimi me burg ishte së ajo llogaritej si mjet më efikas kundër luftimit të kriminalitetit dhe si trajtim i personave të dënuar.

Mirëpo duhet të kemi parasyshë faktin se paraqitja e dënimeve për nga llojet dhe mënyrat e ekzekutimit prej atëher dhe deri më sot ka ndryshuar nuk ka ngelur i njejt.

Rruga në të cilën ka kaluar dënimi me burgim paraqitete në dy faza:

FAZA E PARË APO PERIUDHA EPARË: kjo fazë llogaritete si faza e parë e transformimit të dënimeve me burgim , prej paraqitjes së dënimit me burgim e deri në gjysmën e parë të shekullit XX.

Fazë në të cilën dënimi me burgim është dominues, si dënime që ekzekutoheshin ishin : burgimi, burg i rëndë , burg shtëpiak, burg me pranga etj.¹¹

Kur flitet reth kësaj faze të paraqitjes së dënimit me burgim kemi gjithashtu parasysh edhe mënyrat e vrazhda të ekzekutimit të dënimit me burgim, që kanë qendë të llojllojshme dhe johumane ku i gjith qellimi i dënimit nuk ka qendë riedukimi i dhe riintegrimi i të dënuarve po ishte hakmarja ndaj kryerësve të veprave penale sepse kuhstet në të cilën të dënuarit e vuanin dënimn ishin mjaft të vështira.

¹⁰ R.Gashi: Ekzekutimi I dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë 2001 fq.15

¹¹ R.Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, fq.98

Si burgje të atëhershme për vuajtjen e dënimit ishin bodrumet e kështjellave , kalat e ndryshme me kuhste tejte të vështira sepse në ato burgje nuk kishte dallim moshe, dallim i veprave, të gjithë vunain dënimet së bashku , ku edhe përhapeshin sëmundjet ngjitëse, gjithashtu të njohura ishin edhe infektimet kriminale.

Në literaturën penologjike përmendet prifti Benedictian Mabilon (1632-1707) dhe vepra e tij me titullin :’’Reflexion sur les prisons del orders religieux’’ ku kritikon gjendjen e burgjeve të kohës dhe kërkon reforma dhe angazhimin e të burgosurve në punë,përmisimin e gjendjes higjienike,lejimin e vizitve dhe ishte kundër izolimit absolut të të burgosurve ne qeli.¹²

FAZA E OSE PERIUDHA E DYTË si karakterisite e njohur e kësaj faze qëndron në atë se në këtë periudhë janë të njohura zhvillimi dhe idet e ndryshme për ndryshimin e dënimit me heqje liriye, ku edhe kritikohen ashpër burgjet e atëhershme dhe kërkohen ndryshime rënjësore të shqipitimi të dënimit me burgim.¹³

Ishte një fazë ku shumë prej autorëve mendonin se dënimi me burgim duhet të reduktohet dhe nuk duhet ti ketë qëllimet e mëparshme në të cilën egzistonte hakmarja dhe shpagimi i kryerësve të veprave penale ashtu sic është e njohur në fazën e pare.

Në këtë fazë qëllimi i dënimi me burgim do të ketë riedukimi dhe riintegrimin e kryerësve te veprave penale.¹⁴

Këtë fazë gjithashtu e përbëjnë edhe kontributete e shkollave të njohura sic janë:shkolla pozotiviste italiane, shkolla sociologjike dhe shkolla e mbrojtjes së re shoqërore.

Qëllimi i këtyre shkollave ishte braktisja e hakmarjes dhe shpagimit dhe barktisja e dënimeve prej të cilave nuk pati asnjë rezultat luftimi i kriminalitetit dhe përmisimin e personave të dënuar dhe si qëllim kryesor ishte riedukimi dhe riscializimi i persoanve të dënuar.¹⁵

1.1.2.3.Llojet e dënimeve para paraqitjes së dënimit me burg

Duke pasur parasysh faktin se gjate historisë kanë egzistuar dënime të ndryshme dhe forma e

¹²R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë fq.101-102

¹³ R.Gashi: Ekzekutimi I Dënimit me burgim në Shqipëri,Prishtinë fq.16

¹⁴ R.Halili :Penologjia E drejta e kzekutimit të sanksioneve penale,Prishtinë fq.102

¹⁵ R.Gashi: Ekzekutimi I Dënimit me burgim në Shqipëri,Prishtinë fq.16-17

egzekutimit dhe qëllimi i tyre ka qenë gjithnjë i ndryshëm. Si dënime të cilat mund të njihen për gjatë historisë janë: poshtërimi, ndëshkimet trupore-tortura, dënimet eliminuese, punë të rënda fizike.

DENIMET ELEMNUESE:

I gjithë qëllimi i dënimeve eliminuese qëndronte në atë se ndaj kryerve të veprave penale merreshin aso masa ndëshkimore që ato në mënyrë fizike të eliminohen nga ambient me qëllim që të mos përsëriten vepra penale. Si dënime eliminuese njihen: dënimi me vdekje, dëbimi, deportimi, dhe relegacioni.

DENIMI ME VDEKJE

Dënimi me vdekje është një ndër dënimet më të vjetra e cila egziston edhe sot e kësaj dite. Qëllimi i dënimit me vdekje ishte hakmarhja ndaj kryeresve, gjithashtu edhe opinion. Dënimi me vdekje është ekzekutuar në mënyra të vrazhda dhe mizore. Dënimi me vdekje është paraparë edhe në Kodin Ur-Nammu, është ekzekutuar më së shumti për tradhti. Kurse në Kodin e Hamurabit ki lloj dënimi është paraarë për veprat penale më të rënda. Përgjat historisë dënimi me vdekje është ekzekutuar në mënyra të ndryshme. Sic ishin: Prerja e kokës, pushkatimi, varja, mbytja me gurë, etj. Procedurës së ekzekutimit të dënimit me vdekje i kanë paraprë vuajtje e mëdha dhe mundime fizike.¹⁶

DEBIMI

Ki lloj dënimi egziton që në kohën primitive. Dënim i cili është paraprë në Kodin e Hamurabit, Ligjin e 12 tabelave etj.

Dënim i cili shqiptohet ndaj personave që llogariteshin si të rrezikshëm për shoqërinë, dhe me shqiptimin e këtij dënimi personat e tillë i largonin ose i dëbonin për një periudhë të gjatë kohore ose tërë jetën.

Ky dënim fillon të reduktohet atëherë kur shtete që pranonin personat me këtë lloj dënimi fillonin mos ti pranonin.¹⁷

DEPORTIMI

I cili ishte ishte i ngjajshëm me dëbimin. Dënim i cili shqiptohet ndaj kryeresve të veprave me

¹⁶ https://hr.ëikipedia.org/ëiki/Smrtna_kazna_e_qasur

¹⁷ R.Halili :Penologjia E drejta e kzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë fq.87

qëllim që të largoheshin nga ambientet. Gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, kryerësit e veprave penale kanë pasur mundësinë e gjarkullimit në vendet e huaja, poashtu edhe të drejtën e punës, por vetëm se kanë qenë larg vendlindjes.

Dënim i cili për herë të parë është paraqitur në Portugali dhe Spanjë në shekullin XV. Ky lloj dënimi ekzekutohej në kushte të vështira. Ku edhe nuk ka treguar ndonjë lloj suksesi në pengimin e kriminalitetit.¹⁸

RELEGACIONI

Lloji i deportimit që është aplikuar në Francë. Ky lloj dënimi më së shumti shqiptohej ndaj recidivistëve, ku pas mbajtjes së dënimit kryerësit dërgoheshin në vend tjetër për një periudhë të caktuar kohore. Sëzakonisht personat dërgoheshin në kolonitë franceze ku ato punonin dhe qarkullonin lirë.

POSHTERIMI

Poshtërimi si dënim nuk ka përmbajtur dhembje fizike, por si qëllim i këtij dënimi ishte që kryerësi të nëncmohet, përbuzet dhe përulet në pikëpamje morale, shoqërore dhe njerëzore. Ky lloj dënimi është ekzekutuar për vepra penale të imta siç ishin: sjellja e keqe, thashethemet etj, ky lloj dënimi më së shumti është aplikuar ndaj grave kur është llogaritur se në shoqëri kanë pasur një sjellje jo të hijshme, joshëse, grinacake. Ky lloj dënimi është ekzekutuar në publik ku qëllimi i tij nuk ishte që ndaj kryerësve të shqiptohej dhembje fizike por vetëm poshtërim, dhe të shpiej deri tek pendimi i kryerësi.¹⁹

NDESHKIMET TRUPORE-TORTURA

Tortura apo mundim në vete kanë përmbajtur vuajtje apo mundime shpirtërore me qëllim që të arihet deri tek informatat e nevojshme apo pranimin e fait me qëllim që të arihet deri tek gjykimi.

Tortura si lloj i ndëshkimit është përdorur edhe në kohë më të hershme ku dëshmia është

¹⁸ R. Halili : Penologjia E drejta e kzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë fq.87-88

¹⁹ <https://zir.nsk.hr/islandora/object/unipu%3A646/datastream/PDF/vieë> e qasuar 24.04.2016

karakterizuar me anë të torurës, mundimeve, ose ndëshkimeve trupore. më së shumti janë torturuar skllëvërit dhe të hujait sepse fjala e tyre nuk kishte asnjë vlerë morale-pasi që qëllimi i torturës ishte konstatimi i të vërtetës dhe rëfimi i marë nga ana e të pandehurit i cili edhe konsiderohej i saktë. Në mesjetë gjatë aplikimit të këtijë dënimit ,respektivisht të torturës ka qenë e shfaqur në mënyrë më brutale të mundshme. Ky lloj dënimi është aplikuar në mënyrë publike, ku konsiderohej si një shfaqje e dënimeve ndaj qytetarve që u jepej në dijeni se nuk duhet të sillen ne atë formë,ku deri në fillim të shekullit 18 dhe fillim të shekullit 19 ky lloj i dënimit filloi most ë aplikohet. Justifikimi për këto ndryshime gjenden ne humanizëm ku tortura publike bie në sy. Kështu që drejtësia kërkon të zbatohet jo si një shfaqje publike e rëndësisë së dënimit por si një paralajmrim se kryerësi do të ndëshkohet. Shqipiti i torturë në publik filloi të konsiderohet si negative dhe të reduktohet, kurse aplikimi i dënimit me burgim, kurse puna e rëndë fizike mbetet ne fuqi.²⁰

PUNA E DETYRUESHME

Organizata e Ndërkombëtare e Punës punën e detyruar e përcakton si cdo punë, ose ofrim i ndonjë shërbimi nga ndonjëperson nën kërcënim apo ndëshkim dhe të cilat persona nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre vullnetarisht . Si punë e detyrar nënkuptohet cdo punë që personi është i detyruar ta kryej nën kërcënim kundër vullnetit të tijë .

Puna e detyruar ka një histori të zhvilluar dhe është njohur në mënyra të ndryshme sic janë: ‘robëria’, shtërngim psikologjik ose urdhër të punës e cila është mbështetur nga një kërcënim dënim. Puna e detyruar gjatë gjith historisë karakterizohet si kryerje e punëve të rënda fizike në kushte johumane nënë kërcënim të vazhdueshëm dhe me mbykqirje e cila ishte pjes e dënimit me burgim.²¹

Detyrim i personave të dënuar që të punojnë punë të rënda fizike konsiderohej si dënim i vecantë. Qëllimi i këtij dënimi ishte hakmarja dhe shkaktimi i vuajtjeve dhe mundimeve ndaj kryerësve të veprave penale. Si forma të dënimit me punë të rënda fizike ishin të llojllojshme: ”puna

²⁰<https://zir.nsk.hr/islandora/object/unipu%3A646/datastream/PDF/vieë> e gasuar 24.04.2016

²¹<https://zir.nsk.hr/islandora/object/unipu%3A646/datastream/PDF/vieë> e gasuar 24.06.2016

fizike në anije si lundërtar dhe veltar, puna në xeherore, puna në plantazh, puna në mihjen dhe thyerjen e gureve, puna në celjen e hapsirave të reja tokësore dhe puna të tjera të rënda.”²²

DENIMET PRONESORE

Eshtë dënim i cili ka lindur që në kohën e reagimit privat. Shteti e ka përmbajtur këtë lloj dënimi sepse një pjesë e të hollave shkonin në favor të shtetit si ndërmjetsues mes kryerësit të veprës penale dhe të dëmtuarit, kurse pjesa tjetër shkonin në favor të të dëmtuarit. Më vonë është paraqitur edhe konfiskimi i pasurisë si dënim. Ky lloj dënimi ka gjetur përkrahje por edhe është kundërshtuar, sepse kundërshtuesit e këtij dënimi pohojnë se ky lloj dënimi nuk ka karakter individual sepse ndikon edhe tek antarët e tjerë të familjes të cilët nuk kanë kryer veprë penale. Më së shumti ndikonte tek personat e varfur e jo tek të psur, gjithashtu nuk kishte përmisim tek kryerësit. Kurse përkrahësit e këtij dënimi pohojnë edhe dënimet e tjera janë të njëjta nuk kanë vetëm karakter individual.²³

1.1. Sistemet dhe llojet e dënimit me burgim

KUPTIMI DHE LLOJET

Duke pasur parasysh faktin se burgjet apo dënimet me burgim, kanë shërbyer për zhvillimin e dënimeve me burgim ndaj personave të dënuar dhe mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti. Është shumë e rëndësishme fakti se sistemi i dënimit me burgim ka kaluar faza të ndryshme kohore që dmth se dënimet me burgim nuk ka pasur qëllimin e njëjtë çdo herë, ka ndryshuar në periudha të ndryshme kohore përveç një pike të përbashkët e cila ishte dënim për kryerësit e krimeve. Në të kaluarën qëllimi i dënimit ishte hakmarrja ndaj kryerësve kurse sot në botën moderne ndryshon qëllimi i dënimit, ku si për qëllim ka riedukimin e personave të dënuar.

Sistemet dhe metodat të ekzekutimit të dënimit me burgim të cilat në mënyrë kriminologjike, historike janë lajmëruar prej momentit të paraqitjes të dënimit me burgim e deri në ditët e sotme. Të këtyra sisteme konsiderohen: sistemi i burgim kolektiv, sistemi i

²² R. Halili : Penologjia E drejta ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë fq.91

²³ <https://zir.nsk.hr/islandora/object/unipu%3A646/datastream/PDF/view> e qasuar 24.06.2016

qelisë,sistemi I heshtjes,sistemi I pikave,sistemi progresiv etj.²⁴

1.2.1. Sistemi i burgut kolektiv

Sistemi i cii llogaritet më i vjetri i egzekutimit të dënimit me burgim, sepse është shprehur që në momentin e shqiptimit të dënimit me burgim dhe ka zgjatur deri në reformat e dënimit me burgim , dmth deri në shek XIX.²⁵

Si veti që e bën të dallohet ky lloj sistemi dmth sistemi i burgut kolektiv është se të dënuarit në këtë system ishin të izoluar vetëm nga bota e jashtme , por kjo situatë nuk ndoshtë brenda burgut , sepse kryeresit e veprave penale vuanin dënimin bashkarisht.

Simbas këtij sistemi persoant e dënuar nuk kalasifikoheshin, ku kuptohet se të dënuarit vuanin dënimin bashkarisht pa dallim se a janë recidivist, apo akuzohen për krime të rënda , nuk kishte dallim moshe etj.

Gjithashtu edhe kushtet higjienike kanë qenë të mjera dhe kanë egzistuar edhe sëmundje ngjitse jo vetëm Brenda burgut por janë paërhapur edhe jasht burgut.

Në këto burgje të burgosurit shpesh kanë qenë të keqtrajtuar nga ana e guardianëve.

Disa autore këtë lloj sistemi të burgut kolektiv e kane llogaritur edhe si ‘‘Universitet i vërtet i krimi’’.²⁶

1.2.2. Sistemi i izolimit ose qelisë

Ky sistem vjenë në shprehje pas reformave të sistemit kolektiv.Sistemi i izolimit ose i qelisëështë sistem i parë qëështë rregulluar në mënyr normative dhe për herë të parë paraqitete në qytetin Filadelfia të shtetit Pensilvania të SHBA-ve,në vitin 1790.²⁷

²⁴R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2014

²⁵ R.Gashi: Ekzekutimi I Dënimit me burgim në Shqipëri,Prishtinë fq.

²⁶R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë

²⁷ .Gashi: Ekzekutimi I Dënimit me burgim në Shqipëri,Prishtinë

Ku për herë të parë e praktikojnë besimtarët e një sektre protestante, ku pjestarët e këtij sektri religjioz ishin kundër dënimit me vdekje, dënimeve trupore e torturave të ndryshme. Sipas tyre personat që kanë kryer vepra penale duhet të qëndrojnë në vetmi dhe të mendojnë për veprën e tyre dhe të pendohen. Në këtrë mënyrë personat e dënuar kanë mundësi që të përmissohen në pikpamje morale. Në literature penologjike përmenden dy variant të këtijë sistemi: sistemi klasik i qelisë dhe sistemi i heshtjes apo i Obernit (Auburn-it).

1.2.3. Sistemi i qelisë

System i cili është regulluar juridikisht, e që starton që në vitin 1818, në shtetin Pensilvania të SHBA-ve. Si ent i parë i ndërtuar sipas këtij sistemi konsiderohet burgu në Filadelfi, i njohur si ‘Cherry Hill’. i cili kishte 400 qelia-kthina (me madhësi :2,43x4,57 m), ku secila prej tyre kishte edhe hapësirën e ndarë për shëtitje të të dënuarve.²⁸

Simbas këtij sistemi, respektivisht sistemi i qelisë personat që kanë vuajtur dënimin në këtë system nuk kane pasur konstakt me botën e jashtme, system i cili dallon nga burgu kolektiv sepse të dënuarit në këtë system nuk kanë pasur kontakt poashtu edhe me të dënuarit mbrenda.

Persoant e dënuar kanë pasur kontat vetem me personelin e burug, dhe herë pas herë me priftërijnje gjat meshave..

Ky system ka pasur edhe përparsit e veta , por ka pasur edhe vetit negative.

positive e këtij është se ndalohen trazirat mes të dënuarve

por si negative e kësaj është se të dënuarit me qëndrime për një kohë të gjatë në vetmi të izoluar dhe pa mos pasur kontakte me të tjerët mund të kenë edhe demoralizim, cregullime të rënda shpirëtrorë.²⁹

1.2.4. Sistemi i heshtjes

Sistemi i izolimit të plotë ose sistemit të qelisë, pati kritika të ashpra të cilat kritika patën ndikim jo veteëm në trajtimet teorike por edhe në trajtimet praktike penitensiare. Ku edhe filluan rishqyrtimet dhe reformat e metodës së izolimit të plotë që zbatohet në sistemin e qelisë.

Kështu, në qytetin Obern (Auburn) të shtetit të Nju Jorkut, u bënë përpjekje për reformimin e

²⁸ R, Gashi, vep. e cit. fq. 21

²⁹ R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2014 fq.108

sistemit të qelisë.³⁰ Përmbajtja e këtij sistemi qëndron në atë se personat që vuajnë në këtë system në një farë mënyre kishte regulla të ashpra ndaj të dënuarve përgjat vuajtjes së dënimit, për arsye se të dënuari gjatë natës qëndronin të ndarë nga njëri-tjetri, por nuk dallonte edhe gjatë ditës asgjë ndaj tyre sepse edhe atëherë kishin ndalim komunikimi mes veti.

Cdo lloj komunikimi mes tyre dënohej ashpër, ndaj tyre eliminohesh cdo lloj kontakti për arsye që most ë ketë infektim criminal.

Edhe pse përgjat egzistimit të këtij sistemi, të dënuari kishin të drejtën e punës mereshin em mjeshtri të ndryshme punonin nëpr farma, punishte të ndryshme etj. Mirëpo cdo lëvizje e tyre ka qenë në heshtje sepse sic dihet karakteristik e këtij sistemi ishte heshtja.

Mu për këtë arsye edhe emërohet si „SILENT SYSTEM”

Edhe pse mund të thuhet se kishte aritje të risocilaizmit në këtë system, mirëpo edhe kështu ki system është e pranishme hakamrja dhe vuajtja ndaj të dënuarve.³¹ Duke pasur parasysh këto vecori të këtij sistemi, në literaturën penologjike theksohet se sistemi i heshtjes paraqet një përmisim minimal të pozitës së të dënuarve.³²

1.2.5. Sistemi progresiv

Sistemi progresiv është sistemi i njohur i cili bën përpjekje të rëndësishme në drjetimin e reformave të ekzekutimit të dënimit me heqje lirisht poashtu edhe regullimin e pozitës së të dënuarve. Sistemi progresiv zanafillën e ka prej gjysmës së shekullin XIX.³³ Përgjat periudhës së paraqitjes së këtij sistemi vërehn përpjekjet e mëdha të shoqatave dhe organizatave me qëllim të ndryshimit të insitucioneve të më parshme, gjithashtu edhe përpjekje të mëdha të ndryshimit të pozitës së personave të dënuar. Në këto drjetime është i njohur Kongresi i Fondacionit Ndërkombëtar për të drejtën penale dhe entete ndëshkimore, i mbajtur në Londër 1872.

Në këtë kongres, hartohet programi bashkëkohor për organizimin e insitucioneve korrektuese dhe përmisimin e kushtev të jetesës së persoanve të dënuar. Ku është paarpër edhe aftësimi i të dënuarve, shkollimi i të dënuarve përgjat qëndirmin nënt, poashtu edhe përmisimi i kushtev higjenike në insitucion.

[Poashtu është paraër që edhe personeli i burgut të aftësohet në këtë drjetim me qëllim të

³⁰ R. Halili, vep. e cit. fq 109

³¹ R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2014 fq.111

³² Rexhep Gashi: Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001 fq 22

³³ Rexhep Gashi: Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001 fq 22

organizimit të institucioneve penitenciare dhe zbatimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.

Si karakteristik tjetër e këtij sistemi qëndron në atë se personat e dënuar prej momentit të ardhjes në institucion e deri në dalje kanë pasur mundësinë e ndryshimit të pozitës së tyre, element që është varur nga angazhimi i punës dhe sjelljes së tij.³⁴ Në literaturën penologjike përmenden tri variant të sistemit progresiv : 1. sistemi progresiv anglez, 2. sistemi progresiv irlandez dhe 3. sistemi i poenave ose Makonakut.

SISTEMI PROGRESIV ANGLEZ.

Emërohet në këtë mënyrë pasi që është paraqitur në Angli, më 1853 dhe është aplikuar për personat me dënime afatgjate.

Në këtë sistem të dënuarit kalonin nëpër tri faza dhe ato janë: faza e qëndrimit në qeli apo faza e izolimit, faza e mbajtjes së përbashkët të dënimit të dënimit dhe faza e lirimit me kusht.³⁵

FAAZA E PARË : faza e parë karakterizohet me mbylljen në qeli, dhe moskontaktimi me personat e tjetërë. Fazën e cilën të dënuarve ju është mundësuar ndryshimi i pozitës së tyre me fitim e beneficioneve. Këto beneficione ishin: përmisimi i ushqimit, kushte higjienike, vizita nga jashtë, furnizimi me literature etjere.

Arsye që edhe ndaheshin të dënuarit në grupe dhe nëngrupe.³⁶

FAZA E DYTË: është faza ku të dënuarit janë më të lirë në krahasim me fazën e parë për arsye se në këtë fazë të dënuarit kanë mundësi të qëndrojnë së bashku paqashtu lejohet edhe komunikimi mes veti gjat procesit të kycjes në punë. Gjithashtu edhe shumica e autorëve mendojnë se kjo fazë është faza më e rëndësishme e ekzekutimit të dënimit me burgim, sepse në këtë fazë egzistonte mundësia e trajtimit dhe riedukimit të personave të dënuar. Personat e dënuar duke u kycur në procesin e punës, duke u angazhuar në aktivitete të ndryshme kanë mundësi të aftësohen, të fitojnë mjeshtri dhe zanate të caktuara. Klasifikimi në këtë fazë bëhet sipas disa kriterëve, p.sh. sipas moshës, motiveve të kryerjes së veprës penale, peshës së veprës, lartësisë së dënimit dhe disa kriterëve të tjera. Në këtë

³⁴R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014 fq.111-112

³⁵ Rexhep Gashi: Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001 fq 22

³⁶R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014 fq.113

fazë personat e dënuar kanë mundësi që me sjellje dhe qëndrime të veta të ndikojnë në përmisimin e pozitës së tyre.³⁷

FAZA E TRETË:qëndron në lëshimin me kusht.Që personat e dënuar,edhe pse lirohen para kohe nga burgu ,ato edhe më tej kane obligime dhe detyrime për mirësjellje dhe respektim të ligjit.Ato faktikisht konsiderohen sit ë dënuar dhe se në lirii janë duke u sprovuar,e po që se nuk sillen mirë,e nuk kryejnë obligimet ose kryejnë ndonjë krim lirmimi me kusht do te revokohet .³⁸

SIATEMI PROGRESIV IRLANDEZ.

Ky system për herë te parë paraqitet në Irlandë,në vitin 1854,i cili ka mjaft ngjajshmëri me sistemin progresiv anglez, por është më i përsosur dhe ka aritur ti zbatojë disa risi gjatë ekzekutimit të dënimit me heqje të lirisë.Dallimi esencial ndërmjet këtyre sistemeve qëndron në faktin se sistemi progresiv irlandez parasheh edhe një fazë të vecantë nëpër të cilën duhet të kalojnë personat e dënuar gjatë mbajtjes së dënimit.Kjo fazëështë qëndrimi në paralele për të lirë, e cila parashihet para fazës së lirit me kusht,gjatë së cilës fazë të dënuarit përgaditen për të dalënliri.Sistemi progresiv irlandez,për shkakë të përparsive që ka,shumë shpejt fitoi zbatim të gjërë në praktikën penitensiare,kështu që edhe sot ,me disa ndryshime është në zbatim në shumë shtete.³⁹

SISTEMI I POENAVE.

Ky system është interesant për disa risi dhe parime që janë aplikuar lidhur me tretmanin e personave të dënuar.Këtë system për herë të parë e aplikoi drejtori i entit ndëshkimor në ujdhesën Norfolk,kapiten i marinës angleze ,Aleksandar Makonak,në vitin 1840.Për këtë arsye edhe e ka marë emrin ‘’sistem i Makonakut’’.

Në burgun nëshkimorë në Norfolk vuajshin dënimit kriminelte dhe personat të rezikshëm,të dënuar

³⁷R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014 fq 114

³⁸R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014 fq 114

³⁹ Rexhep Gashi:Ekzekutimi I dënimit me burgim në Shqipëri ,Prishitnë,2001 fq 23

me dënim afatgjate të heqjes së lirisë.Para ardhjes së Makonakut si drjetor në këtë ent, situata ishte e vështirë poashtau edhe personeli i burgut slllej nëmënyrë të vrazhdët ndaj të dënuarve.

Mu për këtë arsye edhe insistonte për të gjetur metoda më të përshtatshme për nxitje dhe stimulin e persoamve tëdënuar , me qëllim që të angazhohen në punë të ndryshme dhe që të ketë sukses përmismi I tyre para se të dalin nga burgu.

Ku edhe parashef poena për secilin të dënuar.⁴⁰

1.2.5. Sistemi i klasifikimit ose i Gjenevës

Eshtë sistem i cili për herë të parë është paraqitur në Gjenevë të Francës .Sistem i cili bëri përpjkeje për të realizuar klasifikimin e personave të dënuar në grupe dhe nëngrupe , ky sistem më shumë llogaritete si një lloj eksperimentimi i cili nuk ka luajtur rol në praktikën e sistemit penitensiar. Sipas sistemit të klasifikimit ose ndryshe i quajtur sistemi i Gjenevës, të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit duhej të kalonin nëpër tre faza::faza e qelisë,faza e mbajtjes së përbashkët të dënimit në bazë të klasifikimit dhe ndarjes së të dënuarve dhe faza e lëshimit me kusht të personave të dënuar. Edhe pse ky sistem nuk u afirmua , por pati ndikim në paraqitjen e ideve për individualizimin e tretmanit të personave të dënuar.⁴¹

1.2.6. Sistemi modern ose sistemi bashkëkohor

Edhe pse sistemet e më parshme penitensiare kanë bërë përpjekje të mëdhaja për të aritur një mënyrë universal tëzbatimi dhe ekzekutimit të dënimit me burgim,mirëpo nuk aritën që të gjenë një mënyrë që do të contë deri tek përmisimi dhe rriedukimi i kryerësve të veprave penale dhe pengimin e kriminalitetit.Vetem pas zhvillimi të shkencës së kriminologjisë dhe kërkimeve empirike kriminologjike të dukurisë së kriminalitetit paraqiten kushte më të volitshme për luftimin e kriminalitetit.Shkollat juridike penale dhe kriminologjike kanëkontribuar vecmas për studimin e arsyeve të kriminalitetit dhe trjatin e qëllimit të sanksioneve penale.⁴²

⁴⁰R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014 fq.116-117.

⁴¹ Rexhep Gashi:Ekzekutimi I dënimit me burgim në Shqipëri ,Prishtinë,2001 fq 24

⁴²R. Halili: Penologjia- E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014 fq.120-121

Qëllimi i Sistemit bashkëkohorë i ekzekutimit të dënimit me heqje lirie ose me burgim, në krahasim me sistemin e me parashëm dallon shumë, për arsye se tek sistemet e veçtra ka qenë më në interes më së shumti hakmarja, vuajtjet, mundimet tek kryerësit e veprave penale. Por sot qëllimi i sistemit të ekzekutimit të dënimit me burgim apo me heqje lirie anon më së shumti në riedukimi dhe risocializimin e personave të dënuar. Sistemi i cili ka aritur që të kejojë kushte të mbajtjes së dënimit me burgim shumë të afërta me kushtet e jetesës dhe të punës së personave në liri.

Gjithashtu edhe në sistemin modern mund të dallohen disa faza nëpër të cilat kalojnë personat e dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me heqje lirie sic janë: faza e observimit dhe studimit të personave të dënuar, faza e klasifikimit të gjerë dhe e individualizimit të tretmanit të personave të dënuar dhe faza e tretë që përfshin lëshimin me kushtë dhe ndihmën postpenale të personave të dënuar. Në këtë sistemin nuk është e pranishme faza e qelisë, por izolimi zbatohet vetëm si masë disiplinore ndaj të dënuarve. Sistemi modern sot gjendet në një proces permanent të përsosjes së mëtejme të tij, ku gjithnjë më tepër po gjenë zbatimin disa risi dhe metodave të reja që janë në funksion të risocializimit të plotë të personave të dënuar dhe pengimin të kriminalitetit.⁴³

1.3. PSIKOLOGJIA E BURGUT

Duke pasur parasysh se me shqipitimi e dënimit me burgim personave të dënuar u kufizohen ose u merret liri dhe të drejtat e caktuara që janë edhe të garantuara me kushtetutë dhe akte ndërkombëtare, por përsëri duhet të kemi parasysh se qëllimi i dënimit me burgim daj të dënuarve nuk paraqet hakmarje për veprën e kryer por risocializim të tyre. Kjo do të thotë se të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit me burgim do t'ju nënshtojnë trajtimeve të ndryshme në burg që të kuptojnë se është gabim që të kryhen vepra penale dhe se duhet të aftësohen me ndonjë zanat që kur të kthehen në liri t'ju shërbejë si profesion dhe të largohen nga rrugët kriminale.

1.3.1. Qëllimi i burgut

Qëllimi i shqiptimit të dënimit me burgim si sanksion penal shërben për qëllime të caktuara. Egzistojnë mendime të ndryshme për qëllimin e sanksioneve penale, e vecanarisht të

⁴³ Rexhep Gashi: Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001 fq. 24-25

dënimin me burgim.” sipas prof. Ejup Sahiti tek vepra Psikologjia e burgut ceket :”se sanksioni paraqet dënimin (shpagimin) e kriminalitetit për veprën penale të krye;se ai bën zbrapsjen individit të dënuar nga kryerja e krimeve të tjera pasi të jetë liruar nga burgu (prevencioni individual),si dhe ti ndalojë ata që kanë prirje për të kryer vepër penale.Një mendim tjetër është se njerëzit burgosën me qëllim që të reformohen ose të rehabilitohen.”⁴⁴

Duke pasur parasysh objektin e psikologjisë gjyqësore ku theksohet se në procesin e zbatimit të dënimin me burgim është e nevojshme të bëhete edhe shikimi nga ana e psikologut , për arsye se ndihmon për të vlersuar personalitetin e të burgosurve dhe ndërmarjen e masave dhe veprimeve në drjetim të risocailazmimit dhe të riaftësimit të tyre.⁴⁵

1.3.2. Të drejtat e njeriut

Të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të qytetarit llogarite si kritere apo kushte themelore që shërbejnë për ngritjen e statusit dhe rolit të njeriut në shoqëri.

Lirit dhe të drejtat e njeriut garantohen me Kushtetutë , si akt më i lartë juuridik.

garantimi i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetaritn shprehen në insitucionete e qeverisë, organiztata joqëveritare, të cilat meren të ilat meren me menjanimin e diskiminimeve të mundshme.⁴⁶

Edhe pse shprehja e të drjetave llogaritete si nocion moder, por faktikisht ajo është e vjetër edhe sa vet njërzimi. Të drejtat e njrriutu dhe qytetraut sot mbrohen me Kushtetut , gjithaahu edhe me formën e Kartës së të Drejtave ,që nuk mund ti mohoj asnjë qeveri.

Gjithashtu edhe janë formuar gjykata të pavaurra ku qytetarëve u janë shkelur tëdrejtat , mund të kërkojnë përmismimin e tyre.⁴⁷

⁴⁴ E.Sahit , vep.e cit. fq 141

⁴⁵ Ejup Sahiti:Psikologjia e Burgut , prishtinë,2007 fq.141

⁴⁶<http://telegrafi.com/te-drejtat-dhe-lirite-e-njeriut/e-qasuar> 11.07.2013

⁴⁷ Ejup Sahiti:Psikologjia e Burgut , Prishtinë,2007 fq.142-143

1.3.3. Kuptimi psikologjik i burgut

Për të luftuar kriminalitetin, nuk është e mjaftueshme që të njihet vetëm psikologjia e krimit në momentin e kryerjes së krimit, por është shumë e rëndësishme njohjo e vetive psigjike të mevonshme, si tek kryerësi ashtu edhe tek persoant tjerë që jane të angazhuar në sqarimin e rasisit.

Edhe pse në fillim psikologjija e burgut është marë vetëm me gjenden psikike të persoanve të dënuar me burgim, por sot ajo ka një interesim më tëgjërë e cila merret edhe me studimin e ndodhive psigjike të personave të privuar nga liria që gjenden në pritje të dënimit, poashtau edhe të atyre që kalojnë një kohu të gjatë në burg..⁴⁸

Eshtë e rëndësishme , që gjatë periudhës së shqipitit të dnëimit më burgim të shikohen rethanat e më parshmë, që nënkupton të gjithë ato rethana që kanë shpier deri tëk kryerje e veprës penale me qëllim që të shqiptohet dënimi adekuat dhe tremanti adekuat ndaj kryerësit të veprës penale me qëllim të përmisimit të tijë.

Poashtu vlen të përmenden edhe mardhëniet mes të burgosurve dhe personelit të burgut sepse mardhëniet mes tyre shfaqin edhe ambient mbrenda burgut.Nëse mardhëniet mes të burgosurve dhe personelit është në mënyr adekuate atëherë edhe jeta në burgë bëhet më e lehtë dhe tretmanet ndaj të burgosurve kryhen me sukses,gjithashtu edhe tensioned mes të burgosurve dhe personelit zvoglohen.Që të krijohet një raport i këtillë në burg duhet që edhe personeli të sillet në mënyr të sjellshme me të burgosurit pa mos pasur maltretime dhe sjellje jo humane ndaj të burgosurve.⁴⁹

1.3.4 Kufizimii lirisë

Liria e personit është një ndër të drejtat themelore të njiut,ku përfshinë të drejtën për të mos u hequr dhe kufizuar liria,përvec rasteve që jane të parashikuara me ligj,të drejtën për tqë mos iu nënshtruar torturës,dënimit apo trajtimit mizorë,cnjerzorë ose poshtërues etj.

Në të drejtën penale thuhet kufizimi ui lirisë logaritet si ‘dënim’ose ‘lloj i dënimit’.Me futjen e sistemit progresiv me rastin e ekzekutimit të këtij dënimi,ku egzekutimi I tij fillon në institucion të

⁴⁸ Ejup Sahiti:Psikologjia e Burgut , Prishtinë,2007 fq.145

⁴⁹ Ejup Sahiti:Psikologjia e Burgut , Prishtinë,2007 fq.149

tipit të mbyllur dhe përfundon me lirim me kusht ose me probacion.

Në të drejtën e procedurës penale për heqje lirie ka interesim nëse kemi të bëjmë me heqje preventive të lirisë (arrest, ndalim, paraburgim).

Mund të thuhet se heqja e lirisë ka të bëjë me marrjen e lirisë personale ndërmjet burgimit, kurse heqja preventive e lirisë nuk është dënim por masë e cila shërben për sigurim të pranisë së të pandehurit në procedurë penale dhe për pengimin e rikryerjes së veprës penale. Me rastin e studimit të cilësive dhe dukurive psikike tek personat e privuar lirie, përfshirë edhe studimin e njejave dhe të gjendjes së vetëdijes duhet pasur parasysh se ndërmjet personave të tillë egzistojnë dallime për të cilat thuhet se janë parasegjithash të natyrës objektive, kurse të tjerat kryesisht psikologjike.⁵⁰

1.1. Mënyra e ekzekutimit të dënimit me burgim

Mënyra se si ekzekutohet dënimi me burgim, nga ana e organave që janë të autorizuar të ekzekutojnë dënimi me burgim paraqet një sistem të ndërlikuar dhe kompleks. Fakti se kjo lloj mase duhet të kryhet me efikasitet të lartë, sepse është e drejtuar kundër personave që llogariten si të rrezikshëm ndaj shoqërisë e bënë që gjatë ekzekutimit të dënimit të ketë organizim special. Ky lloj organizimi ekzekutimit të dënimit me burgim identifikohet si " sistemi penitensiar". Me sistemin penitensiar nënkuptojmë insitucione të specializuara shtetërore (insitucione ndëshkuese korektuese), kadre të specializuara (presoneli i burgut), organe mbykqyrëse, insitucione gjyqësore, personat që vuajnë dënimin në këto insitucione dhe sistemi normativ me të cilin rregullohen mardhëniet me pjesmarësit në këtë funksion.⁵¹

Me problematiken e kriminalitetit, kryerësit e tyre si kryerës individual ose grupor dhe me tentimn për ndalimin e mos kryerjes së veprave penale shoqëria me to meret cdo herë, nuk mund të mburiemi me atë se kanë aritur ndonjë sukses shumë të madhë.

Mirëpo qëllimi kryesor i kësaj teme është dhe përqëndrimi i sajme më i saktë është ndaj mënyrës apo kushteve se si kryhet spo si realizohet dënimi me burgim .

Dënimi me burgim apo dënimi me heqje lirie i kushtohet një rëndësi të madhe, sepse në zhvillimin e shoqërisë së sotme dhe në luftën kundër kriminalitetit dhe kryerësve të sajë ajo është më e rëndësishme dhe realizohen rezultate të ndryshme. Por edhe nga ana tjetër shoqëria ende nuk ka

⁵⁰ Ejup Sahiti: Psikologjia e Burgut, prishtinë, 2007 fq. 147-148

⁵¹ Lupco Arnaudovski: Zatvorenicko Opshtestvo, Shkup, 2000 fq 33

gjetur ndonjë metodë tjetër më efektive kundër kriminalitetit. Dënimi me burgim si sanksion penal dhe mënyra se si realizohet klasifikohet si e domësdoshme për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti të sigurojë një shkallë të lartë të jetesës dhe punë, një shkallë të liris dhe të drejtë njerzive.

Kriminaliteti është i përhapur në masë të madhe, ku shohim një numër të madh të atyre që kryejnë vepra penale gjithashtu vërejmë një numër të madh të atyre që paraqiten si viktime.

Dënimi me burgim egziston për gjatë gjithë historisë e cila është e shprehur me forma të ndryshme e cila shpesh mund të jetë më e repte ose më e butë, e formuar dhe e riformuar, duke shtuar ose hequr elementet repressive duke ndryshuar menyrën dhe kushtet me të cilën ajo ekzekutohet, efektet që dalin prej saj shpesh janë edhe të kritikuar por ky dënim ende egziston.⁵²

Gjatë gjithë historisë së ndëshkimit hasim mendimi të ndryshëm të ndëshkimit ku në kohën e sodit nuk dominon më hakmarja ndaj personave të dënuar por riedukimi dhe riintegrimi i tyre në shoqëri. Pretendohet që personat që kryejnë vepra penale janë ata që në njëfar mënyre nuk janë të adaptuar me kushtet e jetesës dhe punës në shoqëri dhe gjatë qëndrimit nëpër entë ata duhet që të mësohen, të edukohen që normat të shoqërisë përsëri ti respektojnë dhe të udhëhiqen me to.

Duke pasur parasysh sistemin modern, personi i dënuar nuk dënohet sepse ka gabuar por do të nënshtrohet punës riedukative që në të ardhmen mos të përsëris të njëjtat.

Kontribut të madh kanë dhënë edhe mendimet e shkollave kriminologjike, shoqatat ndërkombëtare të cilat kanë trajtuar problematikën e kriminalitetit dhe ekzekutimit të dënimeve me burgim.

Kontribut të madh vecanarisht kanë dhënë Rregullat standard minimale të OKB-së për trajtimin e personave të burgosur, Konventa Evropiane mbi ndalimin e torturës, Rregullat Evropiane të burgut etj. Ku tek të gjitha është theksuar se qëllimi i dënimit me burgim është vetëm riedukimi, risocializimi dhe riintegrimi i të dënuarve.

Me riintegrim ose risocializim nënkuptohet kthimi i të dënuarit në shoqërinë, aftësimin e tij që të jetojë në harmoni me norma shoqërore që të kontribuoj në sigurimin e egzistencës për jetë dhe punë. D.m.th përshtatja e jetesës dhe punës në një ambient. Gjatë qëndrimit në institucion korrektues, personeli si për detyrë ka qëkryerësin ta socializoj dhe riintegroj në shoqëri që në të ardhmen të sillen në mënyrë të drejtë, duke ju përshatur rregullave dhe normave të ambientit të caktuar.

⁵² Lupco Arnaudovski : Zatvorenicko Opshtestvo , Shkup 2000 fq 7

Me termin përmirësim nënkuptohet shkalla e përmisimit të personit të dënuar ,gjendjen në të cilën ka aritur me qëllim që të ketë kujdes që në të ardhmen tu përmbahet normave ligjore dhe morale të shoqërisë. Shpesh herë mundë të ndodhë që në shikim të parë personi mundë të lënë një pasqyr që ka ndryshime, por në realitet ai është i njëjti d.m.th nuk është aritur qëllimi i risocializimit.

Me nocionin riedukim, risocializim dhe riintegrim kuptohet se kryerësit si personalitete ka pësuar transformim në sjelljet, bindjet me veprën të cilën e ka kryer ku gjatë qëndrimit nëpër entë në bazë të tretmaneve adekuate duhet të ketë ndryshuar esencialisht, ku në të ardhmen do të sillet në pajtim me ligjin.⁵³

Kështu arrihen edhe qëllimet e caktuara me nene 37 të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve të RM-së ku është theksuar se qëllimi i zbatimit të dënimit me burgim është aftësimi i personave të gjykuar që të kycen në shoqëri me gjasa më të mira për jetë të pavarur në pajtim me ligjin⁵⁴

1.2. Trajtimi i persoaneve të dënuar

Që në momentin ku risocializimi tek kryerësit e veprave penale u bë një element shumë i rëndësishëm, ku edhe shumë shpejtë mori edhe emrin “tretman”.

Tretmani ka për qëllim “shërimin” e kryerësve të veprave penale në rrugë të insitucioneve, mjeteve metodave sa më efikase për shërimin dhe adoptimin e tyre në përsëri në shoqëri.

Egziston edhe një mendim më i gjërë redh termit tretman që nuk i nënkupton vetëm metodat, veprimet dhe proceset që janë të determinuara vetëm kundër kryerësit e veprave penale por edhe veprimie tjera që ndërmenen kundër ndalimit të kriminalitetit dhe efektit të tij.

Termi tretman sipas penologjisë nënkupton ato metod, veprime, procese, mjete kundër kryerësve me qëllim të risocializimit të tyre gjat ekzekutimit të dënimit dhe tretmanit postpenal që ka për qëllim kycjen në liri me vese positive pas përfundimit të dënimit.

Tretmani është i determinuara në ndryshimin e kushteve të jetesës dhe ambientit të mëparshëm , por gjithashtu edhe ndryshimin e karakterit të kryerësve.

Trajtimi si një system i metodave dhe proceduarave të drejtuara drejt risocializimit të kryerësve

⁵³ Ragip Halili : Penologjia , Prishtin 2014 fq.146

⁵⁴ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale , “ Gazeta Zyrtare e RM-Së” nr. 2/2006, 57/10, 170/13, 43/14, 166/14, 33/15

nënkupton metoda të anës OBJEKTIVE dhe SUBJEKTIVE

Metodat të anës objective në penologji nënkuptohen si ndihmë, që shprehet nëdy mënyra.

Mënyra e parë e kësaj ndihem shprehet si: metoda, proceduara që ndikojnë në ndryshimin e kushteve të jetesës të kryerësve që kanë shty deri tek veprimet kriminale, zgjedhjen e problemeve sociale që kryerësi nuk ka mundëri që ti regulloj vetë këto problem mirëpo që janë të rëndësishme për jetën e tij të ardhme. Eliminimin e këtyre kushteve që kanë sjellur deri tek shprehjet kriminale. Mënyra e dytë e kësaj ndihme shprehet si: ku kjo çon që kryerësi vetë tëndryshoj jetesën e me parshme nëpërmjet edukimit angazhimit, dhe shprehis së punës ,ndryshimin e veseve të tij që në të ardhmen mos të vijë në kundërshtim me sistemin normative.

Metodat subjective, veprimet dhe proceset kanë për qëllim rehabilitimin , dhe riintegrimin e personave të dënuar. Janë të detëruara ndaj personalitete të delikuentit dhe sjellesve të tyre delikente.

Nga e gjithë kjo mund të kuptojmë se tretmani nënkupton një sistem shumë të ndërlikuar të metodave , veprimeve dhe proceseve me të cilat ndikohet në ndryshimin e delikentëve dhe bindjeve të tyre të jetesës⁵⁵.

Për realizimin e tretmanit dhe aritjet e ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj personave të dënuar, duhet të plotësohen disa kushte. Sic janë individualizimi i tretmanit, me studimin dhe observimin e personave të dënuar, me klasifikimin e personave të dënuar , klasifikimin dhe kategorizimin e insitucioneve ndëshkimore- përsmisuese dhe me aplikimin e metodave dhe mjeteve të përshtashme për aritjen e procesit të riedukimit dhe risocializimit⁵⁶.

1.2.1 Klasifikimi i insitucioneve korektuese

Me qëllim të aritjes së sukseshme të individualizimit të tretmanit dhe ekzekutimit të suksesshëm të dënimit me burgim, gjithashtu është edhe klasifikimi dhe kategorizimi i insitucioneve korektuese. Me klasifikimin dhe kategorizimin e insitucioneve korektuese nënkuptohet realizimi i insitucioneve të llojllojshme, me qëllim të zbatimit të tretmanit dhe përshtatjes më të sukseshme për

⁵⁵ Lupco Arnaudovski: Zatvorenicko Opshtestvo, Skopje fq.228-231

⁵⁶ Ragip Halili : Penologjia, Prishtin fq 150

riedukim dhe riintegrimin e personave të dënuar.

Klasifikim dhe kategorizim i insitucioneve nënkuptohet ndarja e insitucioneve në lloje të ndryshme sizakonisht janë të regulluara me ligj dhe dispozita të tjera të secilit shtet.

Klasifikimi i insitucioneve korektuese është system i kohës modern, nuk i përket kohës kur ekzekutimi i dënimit kishite si qëllim hakmarjen e kryerësve ku edhe egzistnin burgje kolektive ose burgje të tipit të mbyllur.ku nuk u kanë kushtuar kujdes riedukimit dhe riintegrimit.

Kjo lloj ndarje apo klasifikimi i insitucioneve korektuese në penologjin modern është shumë me rëndësi,rrugë që ka qenë e gjatë dhe e vështire ku me depërtimin e shkollave të ndryshme juridike-penale dhe kriminologjike, më së shumti ju nënshtrohen njohjes së gjithanshme të personaliteti të delikuentit dhe të të dënuarit.⁵⁷

Nga e gjithë kjo nënkuptojmë se kategorizimi i insitucioneve korektuese nënkupton krijimin e insitucioneve të vecanta dhe të specilazuara ndëshkimore korektuese , të tipeve dhe llojeve të ndryshme të regulluara ndaj kategorive të ndryshme të personave të dënuar dhe karakteristikave të tyre dhe tretmanit më adekuat : duke aritur qëllimin e kushteve të jetesës dhe puna në ente ndëshkuese përmisuese e gjithashtu e gjithë këto shprehi të ngelin edhe në jetën e tyre sitë lirë.⁵⁸

Organizimi dhe kategorizimi i insitucionve bëhet sipas disa kritereve:

* kategorizimi horizontal i enteve ndëshkuese përmisuese i cili bazohet në kriteret objective të cilat janë të parapara në ligj

* kategorizimi vertical icili ka për qëllim kriterin subjektiv dhe individualizimi i tretmanit të personave të dënuar.

Përvec këtyre dy kritereve horizontale (objective) dhe vertikale (subjective) egzistojnë edhe kritere tjera sic janë: organizimi dhe kategorizimi të insitucioneve penitensiare sipas:

* personave të dënuar

*sipas lartësisë së dënimit

*sipas moshës dhe gjinisë

*sipas shkallës së sigurisë etj.

⁵⁷ Ragip Halili : Penologjia , Prishtin 2014 fq. 161-162

⁵⁸ Lupco Arnaudovski : Zatvorenicko Opshtestvo , Shkup fq.217

Sipas kategorisë së personave të dënuar entet ndahen në:

*entë të tipit të përgjithshëm

*ente të specializuara.

Ku në entete ndëshkuese përmisuese të tipit të përgjithshëm vujnë dënimi të gjithë personat e dënuar. Kurse në entete të specializuara vendosen kategoritë e caktuara të personave të dënuara.

Ente të tilla janë : ente për të mitur, ente për recidivistë, ente për personat e dënuar të rijë madhor, ente për personat e sëmure , entë për femra etj.⁵⁹

Sipas rajonit entet ndahen : në komunale, rajonale, republikane, dhe federale.

Sipas shakllës së sigurisë mundëtohen : të tipit të mbyllur, të tipit gjysëm të hapur, dhe ente të hapur. Ndarja në ente dhe nëburgje.⁶⁰

Entet ndëshkuese përmisuese të tipit të mbyllur, të sigurisë së lartë jnë entë në të cilën është prezentë siguria e lart. Tek këto entë sizakonisht e vuajnë dënimin personat agresivë, të reziqshëm dhe recidivistë.⁶¹

Institucionet e llojit të mbyllur kanë sigurimin fizik dhe material, sic janëshërbimi për sigurimin, muret me rrethojë mjete teknike dhe masa të tjera për sigurim me të cilat pengohet arratisja e persoanve të dënuar.⁶² LIGJI PER ZBATIMIN E SANKSIONEVE neni 20 (2)

Institucionet e llojit gjysëm të hapur kanë shërbim për sigurim, i cili e siguron disiplinën dhe kontrollon lëvizjen e personave të dënuar.⁶³ Neni 20 (3)

Ente ndëshkuese përmisuese të tipit të hapur: paraqitete si një insitucion i vecantë

ku regjimi i mbajtjes së dënimit në këtë tip të institucionit është shumë liberal ku mundësohet qarkullimi, lëvizjen, dhe kontaktet mes personave të dënuar të jentë të rëgullt dhe pa kufizime të mëdhaja.Sizakonihst nëpër këto insitucine vendosen ato persona që më parë kanë qenë të vendosue në institucione të tipit të mbyllur ose gjysëm të hapur ku procesi i riedukimit apo riintegrimt ka rezultuar me rezultate positive. Tek këto intitucione më së shumit vëndohen personat e dënuar me burigm afatshkurtë, personat e dënuar për delikte të lehta dhe krime të lehta.⁶⁴

⁵⁹ Mitasin Beqiri : Organizimi dhe gjendja e institucioneve penitensiare ne RM Tetovë 2007 fq.47

⁶⁰ Ragip Haliili : Penologjia ,Prishtin 2014 fq.162

⁶¹ Mitasin Beqiri: Organizimi dhe gjendja e inistucioenve penitensiare ne RM Tetove 2007 fq.48

⁶² Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale , " Gazeta Zyrtare e RM-Së" nr. 2/2006, 57/10, 170/13, 43/14, 166/14, 33/15 neni 20 (2)

⁶³ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale , " Gazeta Zyrtare e RM-Së" nr. 2/2006, 57/10, 170/13, 43/14, 166/14, 33/15neni 20 (3)

⁶⁴ Ragip Halili: Penologjia ,Prishtin 2014 fq.168

1.2.2. Ndarja dhe kategorizimi i personave të dënuar.

Klasifikimit të personave të dënuar rëndësi të madhe filloi ti përkushtohet në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, duke ju falemenderuar përparimit të shkencave sociale dhe psikologjike, gjithashtu është një kohë ku kryerësit e veprave penale nuk shikohen si persona që me vetëdëshirë kanë kryer vepra penale, por kanë qenë të ndikuar nga disa faktorë personalë dhe faktorë tjerë që mund ti rezistojnë. Gjithashtu edhe psikologët konsideronin se shkelja e ligjit nuk është dëshira e vetëm një personi por mund të vijë nga problem të shumta dhe vështirësi të cilat mund të jenë sëmundjet.

Në të njëjtën kohë edhe shkencat shoqërore kondiseron se kryerja e veprave penale nga ana e kryerësit nuk varet vetëm nga dëshira e tyre por paraqitet edhe arsye të tjera siç mund të jenë kushtet e jetesës, përplasjet e kulturave, ndikimi i personalitetit, përkatësia e klasave etj. Për këtë arsye kryerësi i veprave penale duhet më së pari të shikohet si një person i sëmurë, se sa një individ që shoqëria duhet të hakmeret.

Të gjithë këto arsye sollën një revolucion tek mënyra e ekzekutimit të dënimit me burgim ku edhe filloi ndryshimi i saj nga karakteri retributiv në karakterin të rehabilitimit, risocializimit.

Një ndër arsyet më të rëndësishme të aritjes së tretmanit ishte edhe klasifikimi i personave të dënuar, ku pa mos klasifikimin e personave të dënuar nuk mundej që të arrihet qëllimi i tretmanit.

Mirëpo duke shikuar historikisht klasifikimi i personave të dënuar nuk filloi që të aplikohet në fillim të shekullit XX ka qenë e njohur më parë edhe në disa shtete ka qenë shumë e zhvilluar. Është e njohur se në shekullin e mesëm burgjet kanë shërbyer për të mledhur, lipsarët, pijanecët, bixhozë, rugacët gjithashtu edhe ato që kanë pritur të dalin para gjykatës, për arsye se edhe personat që kanë qenë në paraburgim edhe ata që kanë vuajtur dënimin kanë qenë në një burg të përbashkët. Në këto lloje burgjesh ku jeta dhe kushtet e të dënuarve që vuajnë dënimin bahskarisht ishin mizore, ku edhe kushtet higjienike ishin shumë të vështira për këto arsye edhe mbisunduan sëmundje ngjitse ku një numër i madh prej tyre vdisnin..

Situat që ishte e pranishme në shumë burgje të Evropës gjithashtu edhe në Angli, sistemi i cili ishte mjaft i kritikuar ku edhe kërkoheshin reformat e sistemeve penitensiare gjithashtu edhe procesuar

ndaj të burgosurve të jenë më humane.⁶⁵

1.2.3 Klasifikimi i persoave të dënuar në ish- Jugosllavin

Me ligjin mbi ekzekutimin e dënimit 16.02.1929 dhe me ndryshimete 09.10.1931 u sollën kriteret e klasifikimit të burgjeve në Jugosllavi.

- e para ishte kohëzgjatja e dënimit. Ku sipas këtij kriteri burgjet ishin të ndara në burgje dhe enet-ndëshkuese korrektuese , ku nëpër brgje kanë vuajtur dënimin me kohëzgjatje deri 1 vjet kurse nëpër ente më shumë së1 vit.

-e dyta ishte gjinija,

- e treat ishte mosha , ku të miturit mbaheshish ndaras nga të riturit,

- e latërta e kaluara kriminale etë dënuarve,

- gjendja shëndetësore e të dënuarve ,

- lloi idënimit.

Sic shihet apo sic dihet ndëshikii i dënimit nuk është mbajturi sipas kriterëve ku edhe nuk është mundur të sigurohet tretmane dhe metoda bashkëkohore të risocializimit

Më së shumti i është vënë re klasifikimit të brendshëm të ente ndëshkuese korrektuese.

Mirëpo qëllimi kryesor i këtij klasifikimi ishte mbajtja e rendit dhe e disiplinës në burg edhe pse në ato kohë ishin të pranishme regullat se njëent duhet që të posedj pedagog, socilog, persona tjerë professional por përsëri nuk posedonin.

Ligji i atëhershëm në mënyrë të plotë e ka pranuar ligjin irlandez gjatë ekzekutimit të dënimit me burg, ku gjatë vuajtjes së dënimit kryerësit e v.p. gjatë periudhës së qëndrimti në burg është dashur të kalojnë në 4 shkallë:

* shkalla e parë qelia

* shkalla e dytë burg i përbashkët

* shkalla e tretë hapsira për të lirët

* shkalla e katërt lirimi me kusht

Në të njëjtën kohë në klafisikimin intern egzistonin edhe tre grupe tjera të ndara njëra prej tjetrës.

--Shkalla e parënë ligj parashihej ‘ ’ në kohën që qendrojnë në vetmi edhe në pushim qëndrojnë të ndarë nga të tjerët ose gjatë ritualeve fetare edhe në shkollë. Që nënkuptohet se personat që

⁶⁵ Dr.Dragomir Davidovic,Olgica Matic,Branko Vukadinovic I Branimir V:Kategorizacija Kazenono* Popravni Domova I klasifikacija osudjeni lica u Jugoslavij , Beograd 1970 fq.17-26

qëndrojnë në vetmi u ndalohet cdo lloj kontakti me të tjerët., porces i cili zgjat prej 3 muja deri në 1 vitë.

-- Pas mbarimit të shkallës së parë të burgosurit kalojnë në shkallën e dytë e ashtuquajtur burgu ipërbashkët.

-- Shkalla e tretë përfshinë pjesën ku kruesit kalonin në të ashtuquajturën reparti i personave të lirë. Lirimime kusht

Kështu që të gjithi i kalonin këto faza.

Ky klasifikim intern nuk ka mbaruar me kaq, ishte vetëm hap i parë, klasifikimi i mëtejshëm vijon në shkallën e dytë të ashtuquajtur burgu kolektiv. Re gull e cila nuk ka qenë regulluar me ligj, por me shkrime të tjera që kanë mbetur në fuqi edhe pas sjelljes së Ligjit mbi ekzekutimit e dënimit.

Të burgosur që kanë qenë shkallë të dytë d.m.th. burgu i përbashkët ka qenë i ndarë në dy klasa

1. Persona të burgosur për herëtore deri 3 muaj.
2. Recidivistë.

Recidivistët kanë qenë të ndarë në tre grupe:

- 1 recidivistë që nuk mundë të konsiderohshin të dështuar
- 2 recidivistë që kanë kryer vepra penale nga lakmia
- 3 recidivistë të tjerë

Ky klasifikim i brendshëm i këture dy burgjeve Sremskoj mitrovici – Lepoglavi (mund të thuhet se ky klasifikim ka qenë i pranishëm edhe në burgjet e tjera) i gjithë sistemi mundë të thuhet se ka pasur dy karakteristika

1. Ligjin irlandez mbi ekzekutimin e dënimeve dhe klasifikimi intern i të burgosurve.⁶⁶

Duke pasur parasysh faktin se të gjithë metoda që ndërmeren kundër kryerësve është në dobi të tyre, ashtu sic është edhe rasti me klasifikimin e kryerësve, ku sipas disa autorëve kjo paraqet një çështje penologjike shumë të rëndësishme dhe të praktikës penitësiare.

Klasifikimi i personave të dënuar gjithashtu parashihet si kusht për soshializim dhe riedukim.

Klasifikimet e më parme të personave të dënuar ka qenë e orientuar nga nevojat kriminale-politike

⁶⁶ Dr. Dragomir Davidovic, Olgica Matic, Branko Vukadinovic | Branimir V: Kategorizacija Kazenono* Popravni Domova | klasifikacija osudjeni lica u Jugoslavij, Beograd 1970 fq.50-60

dhe etiologjike, kurse sot më së shumti janë të orientuara në gjetjen e metodave dhe mjeteve më të përshtatshme për rehabilitimin dhe riiintegrimin e të dënuarve.

Klasifikimi i kryeresve si temë ka qenë shumë e diskutueshme në shumë tubime dhe kongrese, shoqatave dhe organizatave profesionale ndërkombëtare që merëshin me luftimin dhe pengimin e kriminalitetit dhe përmirsimin e kryeresve.⁶⁷

Në kongrese të Komisionit ndërkombëtar për të drejtat penale dhe për entetë ndëshkimore, ku edhe është bërë fjalë për klasifikimin e personave të dënuar.

Në Kongresin e V-të këtij Komisioni që është mbajtur në Paris 1895 ku si kriter i klasifikimi të të dënuarve është cekur të mërrët parasysh edhe sjellaj e mirë dhe disiplina e tyre në punë. Nëpërmjet Kongresit VII 1905 që është mbajtur në Budimpeshta, ku si kritere për klasifikimin e personave të dënuar u mor edhe disa veti dhe cilësi morale të të dënuarve me qëllim të ndarjes së personave tëprishur moralisht dhe ndarjen ka mersonat e mitur. Më pas IX Kongresi I mbajtur në Londër dhe Kongresi I fundit I mbajtur në Hagë në 1950.⁶⁸

Sipas gjithë kësaj mundë të thueht se klasifikimi i persoanve të dënuar nënkupton ndarjen dhe grupimin e personave të dënuar në grupe dhe nëngrupe, sipas moshës, gjinisë, recidivizimit, gjendjes psigjike, dhe shpirtërore, gjendjes shëndëtësore etj.⁶⁹

Sot njihen dy sisteme kryesorë të klasifikimi të personavë të dënuar. Sic janë :

* klasifikimi i jashtëm ekstern : ku sipas disa autorve quhet edhe klasifikimi horizontal, ndarja e persoanve të dënuar bëhet sipas disa kritereve objektivë, ku meret parasysh moshë, gjinia, lloj i dënimit dhe lartësia e dënimit, lloj i veprës dhe fakti i përsëritjes së v.p. klasifikim i cili bëhet në bazë të parimeve juridike penale sipas ligjeve positive. Pra ky klasifikim bëhet para se të vijë perosni i dënuar nënt.

* klasifikimi i brendshëm intern : ndryshe quhet edhe klasifikim vertical i cili bazohet në vetitë, cilësitë dhe karakterisitkat subjektive, individuale dhe të brendshme të secilit persoan të dënuar.

Këto veti vërtetohen në bazë observimit shkencor dhe empiric. Dallimi midis klasifikimi të jashtëm dhe të brendshëm është se klasifikimi i jashtëm bëhet vetëm në bazë të ligjit dhe vendimeve të gjykatave, kurse ai intern bëhet nga vetë personeli i insitucionit ndëshkimor-përmisues.

Disa nga autorë mendojnë se perosnat e dënuar duhet qetë radhiten në persona me veti të njejtë

⁶⁷ Ragip Halili:Penologjija, Prishtin 2014 fq 156

⁶⁸ Lupco Arnaudovski dhe Violeta Caceva :Zatvorenicko Opshtestvo, Skopje 2000 fq.207

⁶⁹ Ragip Halili:Penologjija, Prishtin 2014 fq 157

dhe grupe me veti të ngjajshme. Sipas kësaj duhet të krijohen grupe **homogjene** ku mendohet se mundë me lehtë të punohet dhe të aplikohen metoda të ngjajshme të riedukimit dhe riintegrimi dhe më lehtë punohet me personat që kanë veti të ngjajshme fizike, psikike dhe morale. Kurse grupi heterogjen është më vështirë të punohet dhe të arihet sukses i riedukimit dhe riintegrimit, grup ku janë të pranishëm mosmarrveshjet që ndalojnë procesin e riedukimit.⁷⁰

1.3. Tretmani i të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit

Duke u bazuar në atë se aritja e qëllimit të risocializimit dhe riintegrimit të personave të dënuar gjatë qëndrimit nëpër institucione korrektuese dhe ente edukuese përmisuesë, duhet që të aplikohen mjete dhe metoda të ndryshme ndaj delikuentëve. Duke pasur parasysh realizimin e këtij programi apo tretmani duhet që të mëlidhen apo gjenden metoda sa më efektive, apo rrugë sa më efektive për realizimin e tretmanit më të suksesshëm ndaj delikuentëve.

Ndodh që mos të dallohen kuptimi i mjeteve dhe metodave për risocializimin e të dënuarve dhe metodave të trajtimit të të dënuarve nëpër ent.

Me metodat e trajtimit nënkuptojmë ato veprime dhe masa ku personeli i institucionit i ndërmer ndaj të dënuarve, kurse me metodat e riintegrimit kuptojmë zgjedhje e veprimeve, masave dhe mjeteve me qëllim të aritjes së riintegrimit dhe riedukimit të personave të dënuar.

Nga e gjithë kjo nënkuptojmë se metodat janë një proces i paramenduar dhe i organizuar me qëllim të aritjes së rezultateve sa më të mira të riintegrimit dhe riedukimit.⁷¹

Si metoda që aplikohen për riedukimin dhe përmisimin e të dënuarve janë:

- “ 1.puna e personave të dënuar
- 2.puna individuale nga ana e personelit të institucionit me personat e dënuar.
- 3.puna grupore e personelit të institucionit me personat e dënuar.
- 4.vetorganizmi i personave të dënuar\
- 5.arsimi dhe shkollimi i të dënuarve
- 6.aftësia profesionale e të dënuarve

⁷⁰ Ragip Halili:Penologjia, Prishtin 2014

⁷¹ Ragip Halili:Penologjia, Prishtin 2014 fq 171-172

7. Organize i jetës kluturore zbavitse e të dënuarve.’’⁷²

1.Puna e personave të dënuar

Angazhimi i persoanve të dënuar në punë gjatëgjatë procesit të riintegritit konsiderohet një ndër faktorët më të rëndësishëm.Poroces i cili ka kaluar në faza të ndryshme e cila nuk ka pasur cdo her qëllimin e njet për arrije të riintegritit.

Faza e parë punës: nëpër burgje dhe entë ndëshkuese përmisuese sic është njohur më parë ka pasur karaktern shumë më të ndryshëm se sot, më parë puna që është shprehur nëpër burgjet ka pasur karakter të hakmarjes dhe të shpagimit ndaj të dënuarve. Perosnat e dënuar punoni punë tërënda fizike ku edhe toruroheshin me qëllim të ndëshkimit. Si puna më të përmendura ishin: puna nëpër anije, xeherore, ndërtim në rugët publike etj,

Faza e dytë :fazënë të cilën qëllimi i punës e ndërton përmbajtjen , ku më nuk ka pasur karakter të hakmarjes apo vuajtjes dhe mundimeve . pork a pasur karakterin ë përmisimit të të dënuarve.

Përsësi edhe në këtë fazë nuk kemi ndryhsimin e qëllimit të punës së personave të dënuar.

Fzaa e tretë:është një fazë me rëndësi e karakterit të punës për aryse së në këtë fazë karakteri i punë ndryshon totalisht ku ajo fillon të mar tjrajtën e mjeteve apo metodave të rëndësishme për risocializimin apo riintegritin e të dënuarve. Është fazë me rëndësi sepse kryerësit këtu duhet që të binden dhe të krijojnë shprehi për të punuar në të ardhmen ë tyre në liri,puna për to duhet që të ngel si shprehi dhe ndryshim i sjelljeve të tyre, ku nëpërmjet punës jeta e tyre do të jete e pavarur dhe dinjitoze në shoqëri. Në këtë fazë puna llogaritet si një terapi adekuate për ndryshimin e polto të tyre.I gjithë procesi i punës së të dënuarve nëpër burgje apo insitucione ndëshkuese duhet të jëti i njejta si puna në liri.⁷³

2.Puna idnividuale nga ana e personelit të insitucionit me personat e dënuar.

Përvec punës së personave të dënuar si metodë tjetër për realizmin e tretmanit tësukseshëm konsiderohetangazhimi dhe puna e perosnelit dhe shërbimeve të ndryshme të insitucionit ndëshkimor-përmisus me të dënuarit. Ku përmendet puna individualee edukatorit, puna në grup me

⁷² Vep.e cituar: Ragip Halili:Penologjija , Prishtin 2014 fq

⁷³ Ragip Halili:Penologjija , Prishtin 2014 fq

të dënuarit si dhe forma të tjera.⁷⁴

* përgaditja dhe aftësia personale e personelit të insitucionit korektues.

sisitemet bashkëkohore që kanë për qëllim riedukimin e personave të dënuar , është e paraparë që edhe personeli i tij të ketë kualitet profesional që do të zbatohet edhe procesi i redukimit dhe përmisimit i sukseshëm. Në enete e mëdha penitensiare dhe modern nëse personeli nuk ka kuandër të specilaizuar automatikisht nuk mundet që të arihen rezultatet e kënaqshme. Kujdes të posacëm kësaj çështje i kanë kushtuar tubimet dhe kongreset e organizatave dhe asocioneve ndërkombëtare që meren me pengimin e kriminalitetit dhe trajtimin e të dënuarve.. Regullat standarde minimale mbi trajtimin e të dënuarve kanë përcaktuar kushte dhe parime që duhet ti plotësoj personeli me qëllim të arritjes së sukseshme të riedukimit të të dënuarve. Sidomos kërkohet që personeli të ketë aftësi elementare profesionale dhe praktike nga fusha e pedagogjisë, sociologjisë, psikologjisë, kriminologji penologji e fusha tjera, sepse nëse personeli nuk është i arsimuar dhe nëse nuk ka njohuri profesionale atëher nuk janë në gjendje të kryejnë funksionin e vet.⁷⁵

*Puna individuale e edukatorit me persoant e dënuar

Puna individuale e edukatorëve në insitucion me personat e dënuar konsiderohet një mjet dhe metodë e rëndësishme për aritje të riedukimit. Kjo lloj metode e përcjell personin e dënuar që në momentin e pranimit nënt deri sat ë lëshohet nga vuajtja e dënimit, ku me anë të kësaj metode bëhet njoja e plotë e e personalitete të të dënuarit, sjellja në ent, këshillat, arsimimi, orinetimin profesional. Është një metodë nëpërmjet së cilës i dënuari udhëhiqët drejt rieduimit dhe riintegrimin.

si metoda të edukatorit me personat e dënuar janë:

METODA E BINDJES: është një metodë e edukatorëve dhe puntorvë tjerë penitensiar ku duhet persoant e dënuar ti bandit për qëndrimet, veprimet dhe sjelljet e tyre negative dhe ti ndryshojnë ato Në drejtim tjetër. Që të binden personat e dënuar duhet të bëjshë nje përpjekje permanente dhe biseda të përdisthsm me qëllim të ndryshimit të bindjeve të tyre.

⁷⁴ Ragip Halili:Penologjija , Prishtin 2014 fq

⁷⁵ Ragip Halili:Penologjija , Prishtin 2014 fq

METODA E KRIJMIT TE SHPREHIVE. Metodë nga ana e personelit që do të shty personat e dënuar të ndërtojnë vetet e tyre të më parshme që kanë çuar ato deri tek sjelljet kriminale, në adoptimin e shprehive të reja ku si shprehje do të jetë puna, higjiena personale e tyre, shprehje për mirësjellje etj. E gjithë kjo mund të vijë me mbyqirjen e edukatorëve dhe personelit penitenciar.

METODA E NXITJES: është një aktivitet i cili është i paramenduar shumë mirë nga ana e personelit ku do të zgjoj motive, dëshira vullnet tek të dënuarit për përmirsim. Si metoda për nxitje nga ana e personelit janë : premtimet, lavdatat , dhuratat etj.

METODA E PREMITMIT DHURATAVE DHE SHPËRBLIMEVE NË MËNYR PUBLIKE. ku i përkushtohet një kujdes të madh për arsye se ajo nxihet të dënuarit në punë të dobishme, mirëpo duhet patur shumë kujdes mos vjen deri tek xhelozija e të dënuarve .

METODA E SHTËRNGIMIT DHE E NDËSHKIMIT:

është një metodë që ndërtohet në ato momente kur metodat e më parme që janë aplikuar nuk kanë pasur efekt pozitiv , kur ë mënyra të hapura nuk respektojnë rregullat dhe normat ligjore e posaçërisht rendin shtetëror në institucion .Këto lloje masa të shtërngimit apo ndëshkimit që meren kundër të dënuarve nuk përcillen me vuajtje psikologjike , apo fizike por duhet të ketë qëllim që personi i dënuar të heq dorë nga sjelljet negative.⁷⁶

PUNA E PUNTORËVE SOCIALË ME PERSONAT E DËNUAR

Puna e punëtorëve social ka gjithashtu rëndësi të madhe sepse ato janë persona që do të ndihmojnë të dënuarve gjatë qëndrimit të tyre në entet të tejkalojnë gjendjen e krijuar me faktin e kryerjes së krimit dhe privimit nga liria.Punëtori social ofron ndihmë të dënuarve që të tejkalojnë vështirësitë gjatë qëndrimit në institucion posaçërisht u ndihmojnë në rregullimin e marrëdhënieve familjare martesore etj.⁷⁷

PUNA E PPSIKOLOGUT ME PERSONAT E DËNUAR

⁷⁶ Ragip Halili:Penologjia , Prishtin 2014 fq

⁷⁷ Ragip Halili:Penologjia , Prishtin 2014 fq

psikologët si ekspertët e tjerë, luanë një rol të rëndësishëm për tretmanin e dënuarve. Njohuritë dhe angazhimet e tyre profesionalendihmojnë që të dënuarit tu përshaten jetës dhe punës në insitucionin korektues. Si punë ose veprime më të shpeshta që ndërmer psikologu janë zbatim i teste të ndryshme, intervista biseda dhe konsultimeve të ndryshme me personat e dënuar.⁷⁸

PUNA E MJEKUT DHE PUNËTROVE SHËNDETËSOR ME PERSOANTE E DËNUAR.

mjekët dhe punëtorët shëndetësor si persona specialit që kujdesen për shëndetin e të dënuarve ato gjithashtu luanë një rol të rëndësishëm tek tretmani individual dhe kolektiv i të dënuarve. Nga praktika penitensiare thekoshet se personat e dënuar më së shumt ju besojnë mjekut dhe psikiatrit dhe rëhfehen për jetën e tyre problem që i preokupojnë, nga e gjithë kjo del se mjekët dhe punëtorët shëndetësor përveç se kujdesen për shëndetin e tyre aro gjithashtu kanë një ndikim të madh pozitiv të tretmanit sepse kanë një besimim më të madh tek to.⁷⁹

PUNA E INSTRUKTOREVE ME PERSONAT E DËNUAR

nëpër insitucione korrektuese dhe educative me qëllim që të arihet procesi i rieduimit dhe riintegritit të dënuarve në këtë proces janë të kycur edhe instruktorët si ekspert të profileve të ndryshme. Janë persona ekspert të degëve të ndryshme ku dhe detyra e tyre është të mësojnë dhe aftësojnë personat e dënuar në procese të ndryshme të punës teknologjike dhe mjeshtri të caktuara. Instruktorët janë ata që duhet të cojnë të dënuarit të kycen në procesin e punës, të fitojnë shprehje pune, të mësojnë mjeshtri me një fjalë të përsosën ato.⁸⁰

METODA E TRETMANIT GRUPOR ME PERSONAT E DËNUAR

Është një metodë që mund të zbatohet në dy forma sic janë
METODA E KËSHILLIMEVE GRUPORE: është një metodë relativisht e re e cila zakonisht me një grup personash që mund të përbëhet prej 5 deri 10 personat ku zakonisht debatet dhe bisedat bëhen në lokale të përshtatshme për metodën grupore. Zakonisht është një metodë që bëhet nëpër

⁷⁸ Ragip Halili: Penologjia, Prishtin 2014 fq

⁷⁹ Ragip Halili: Penologjia, Prishtin 2014 fq

⁸⁰ Ragip Halili: Penologjia, Prishtin 2014 fq

(2) Policia e burgut kryen sigurimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur, sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit dhe objektet e tyre të nevojshme për ruajtjen e sigurisë dhe kryen edhe punët e tjera të përcaktuara me ligj.”¹¹⁹

1.1.4. Plani i sigurimit në Burgun e Tetovës

Plani i sigurimit

Me anë të këtij plani e shofim në mënyr tëpërafërt orarin e antarëve të sektorit për sigurim , vendet e punes , detyrat e tyre që janë të angazhuar ti kryejnë në kohë të zakonshme dhe jashtëzakonshme në ent.

Antarët që e përbëjnë këtë sector punojnë sipas këtyrë rregullave:

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve:

¹¹⁸ Ragip Halili:Penologjija, Prishtin 2014 fq.203

¹¹⁹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale , “ Gazeta Zyrtare e RM-Së” nr. 2/2006, 57/10, 170/13, 43/14, 166/14, 33/15 neni 54-a

Ligji për Procedurën Penale – dispozitata për paraburgim

Rregullorja për armët dhe mënyra e kryerjes së veprimtarive në sektorin e sigurimit në institucionet penitensiare dhe korrektuese;

Udhëzimet mbi kushtet dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve të shtërngimit nga ana e antarëve të sektorit të sigurisë.

Rregullorja për uniformën dhe përcaktimet e antarëve të Sektorit për Sigurinë e Burgjeve dhe Institucioneve Korrektuese;

Rregullorja për Rregullat e Shtëpisë për Ekzekutimin e Masës së Paraburgimit në Departamentet e Burgjeve

Kodi i Zyrtarëve në kryerjen e detyrave në institucionet penitensiare dhe korrektuese;¹²⁰

Plani për sigurimin e institucionit;

Anëtarët e sektorit të sigurisë kryejnë detyra lidhur me sigurimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur, sigurinë e jashtme dhe të brendshme të institucionit dhe ndërmarin masa të tjera të nevojshme për të mbajtur rendin dhe disiplinën e institucionit.

Aktivitetet brenda fushës së Sektorit kryhen nëpërmjet Departamentit për Siguri të Brendshme dhe të Jashtme.

Anëtarët e sektorit të sigurisë që kryejnë detyra brenda njësisë së sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm ndërmarrin masa dhe aktivitete që lidhen kryesisht me:

- mbikëqyrjen e hyrjes dhe daljes së të dënuarve dhe të paraburgosurve;
- pjesëmarrje aktive në procesin e ri-socializimit të të dënuarve;
- kryerjen e inspektimit të dërgesave për personat e dënuar dhe të paraburgosur;
- kërkimi i personave dhe lokaleve;
- Ruajtja e rendit dhe disiplinës së brendshme të të dënuarve dhe të paraburgosurve;
- kujdes për zbatimin e Rregullores së Shtëpisë së Institucionit;
- mbikëqyrja e personave të dënuar dhe të ndaluar gjatë ecjes, pushimit dhe gjumit;

¹²⁰ Të dhëna të mara nga Planisi I sigurimit në burgun e Tetovë

- kryerjen e detyrave dhe detyrave të tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e personave dhe institucioneve të dënuara dhe të ndaluara.

Siguria e jashtme konsiston në sigurimin e rrethimit të murit dhe hyrjeve të institucion me patrullime .

Siguria e brendshme kryhet në të gjitha ambientet ku ndodhen personat e dënuar dhe të paraburgosur.

Anëtarët e sektorit të sigurisë janë përgjegjës për përcjelljen e të dënuarve dhe të paraburgosurve, ku edhe janë përgjegjës për detyrat sic janë:

- kryerjen e sjelljes së personave të dënuar dhe të paraburgosur;

- të marrin masa për të parandaluar ikjet dhe kapjen e atyre që vuajnë dënimin;

- në rast të ndërprerjeve të mëdha të rendit dhe disiplinës, greva, lufton masive dhe forma të tjera të çrregullimit, personat që janë përgjegjës për sektorin e sigurimit veprojnë me anë të rregullave , udhëzimeve që janë pjesë përbërëse e këtij plani.¹²¹

1.1.5.MENYRA SE SI I KRYEJNË PUNET NE SEKTORIN E SIGURIMIT

Shërbimii sigurisë në burgun e Tetovës është i përbërë nga 24 anëtarë të sektorit të sigurisë, nga të cilat 1 kryeshef i uniformës , komandant 1 dhe 22 vëzhgues sigurimi (21 meshkuj dhe 1 femër).

Siguria e institucionit kryhet 24 orë në vazhdimësi në 4 ndërrime me 12 orë kohë pune. Orari i punës i zhvendosjes së parë është nga ora 8.00 deri në orën 20.00, kurse zhvendosja e dytë është nga ora 20.00-08.00.

Gjatë çdo ndërrim , personat nga ndërrime të vjetra dhe të reja kryejnë bëjnë kontrollin e lokaleve dhe përcaktojnë gjendjen e numrit të të gjithë personave të dënuar dhe të paraburgosur. Personi përgjegjës i ndrimit të vjetër e informon ndrimin që vjen për cdo gjë që ka ndodhur në insitucion. Këto të dhëna regjistrohen nga ndrimi përkatës.¹²²

¹²¹ Të dhëna te mara nga Plani I sigurimit në burgun e Tetovë

¹²² Të dhëna te mara nga Plani I sigurimit në burgun e Tetovë

1.2.Mënyra e pranimi të të burgosurve.

Në cdo insitucion penitensiar është e domësdoshme që të ketë qendër pranimi , gjithashtau këtë qendër pranimi e posedon edhe sistemi jon penitensiar.

Mënyra e pranimi të tëburgosurve në sektorin e pranimi luan një rol shumë të rëndësishëm , gjithashtau edhe organizmii i tyre i cili duhet të jetë sa më mirë sepse e gjith puna që kryhet në zyrat e pranimi varet shumë edhe tretmani i të burgosurve.

Në momentin që vijnë personate e dënuar në insitucinet ndëshkuese përmisuese, hapi i par i tyre është se ato duhet të paraqiten në qendren e pranimi.

Në qendrën e pranimi të burgosurit sizakonisht qëndrojnë 15 ditë.

Gjatë periudhës së qëndrimit në qendrën e pranimi të dënuarve u meren të gjitha të dhënat e tyre personale, me antë të letërnjoftimit të tyre bëhëtë edhe identifikimi i tyre, personi i cili paraqitete në qendër e pranimi menjëher i lentë gjitha gjërat personale të tijqëi posedon ku më pasë relaizohet edhe dosja e personit të dënuar.

Në dosjen e secilit të dënuar më parë shënohen të dhënat persoanle të tij dhe families, me këtë kuptojme emrin mbiemrin, datlindjen, vendin e lindjes shkollimin e tij, gjendja martesore e ti, a ka fëmij, nacionaliteti i tij, veprën për të cilën akuzohet, a ka qen i dënuar me parë ose është hera e par e tij që ndodhet në burg , koha e mbajtjes së dënimit. Në këtë rast është e rëndësishme edhe marja e informatave nga vet idënuari për fëmirin e tij, ku ka jetuar në cafr rethanash, si ka jetuar, cfar tipi i fëmijës ka qen, normalisht edhe skollimimi i tij a ka qen i regullt apo me ndërprerje.

Më pas vijon edhe mendimi i mar nga ana e psikologut për personin e dënuar, behët edhe amneza kriminologjike, ku të gjithë këto janë të rëndësishme për arsye se me atë të të gjithtë të dhëat për të dënuarin me pas caktohet edhe tretma adekuat për to, me qëllim të risocilizimit.

E gjith kjo procedur bëhët nëpajtim me ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të përcaktuara në nënin 97''gjat pranimi të personit të dënuar në insitucion përcaktohet idenditit i tij në bazë të leternjoftimit , ose dokumentiti tjetër të përshtatshme për përcaktimin e identitetit.'' (2)''të dhenat duhet të jentë identike me të dhënat e përmbajtura në dokumentet persoanle në bazë të të cilave përcaktohet identiteti i personit të dënuar.''

(3) Nëse të dhënat nga paragrafi (2) të këtij neni nuk janë identike ose nuk mund të përcaktohet identiteti i personit të dënuar, institucioni është i detyruar që në afat prej 24 orësh të ndër marrë masa për përcaktimin e identitetit nëpërmjet evidences së Ministrisë për punë të brendshme.’’¹²³ neni 98 ‘‘Të gjithë këto të dhëna per ditën dhe orën e pranimit të personit të dënuar në institucion, identiteti i tij, numri i aktit dërgues dhe numri dhe data e katgjykimit , të dhënat nga hetimi i personalitetit të personit të dënuar dhe raporti për gjendjen e tij shëndetësore, regjistrohen kompletohen dhe ruhen si dokumente zyrtare me natyrë secrete , të cilat janë të afërta vetëm për personat zyrtarë.’’‘‘Me këtë nen është përcaktur se në insitucionin në të cilat zbatohet dënimi me burg deri tre vjet në seksionin pranues personi i dënuar mbahet deri 15 ditë. ‘‘¹²⁴

1.2.1.Dobësit e funksionimit të zyrave të pranimit

Ashtu si janë paraparë në insitucionet penitensiar zyrat e pranimit në botën bashkëkohore ashtu është edhe tek istitucionete tona penitensiar, gjithë që është e rregulluar edhe me Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nenin 97, Rregullat minimale standarde të OKB-së dhe rregullat Evropiane të Burgut .¹²⁵

Tek zyrat e pranimit në insitucionete penitensiare në Maqedoni , personat edënuar mund të qëndrojnë prej 15 ditë deri në 30 ditë varësisht prej lartësisë së dënimit ,a është dënim deri dy vite , ose dënim mby dy vite.

Personat që ju është shqiptuar dënim me burgim deri në 3 vite ato persona qëndrojnë në qendrat e pranimit deri 15 dit , kurse persoanve që ju është shqiptuar dënim me burgim mbi 3 vite ato qëndrojnë në zyrat e pranimit deri 30 ditë. Rregull që është edhe e paraparë në nenin 98 al 3 në Ligjin mbi Ekzekutimin e sanksioneve penale.

Si detyrë që kanë zyrat e pranimit në insitucionet penitensiare është të identifikohet personi dënuar , bëhet investigimi i persoanve të dënuar sipas aplikimit të metodave psikologjike dhe

¹²³ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale , ‘‘ Gazeta Zyrtare e RM-Së’’ nr. 2/2006, 57/10, 170/13, 43/14, 166/14, 33/15 neni 97

¹²⁴ Po l njejt ligji neni 98

¹²⁵ Mitasin Beqiri :Organizimi dhe gjendja e insitucioneve penitensiare ne RM Tetovë fq

psikiatrike kriminologjike, ku në këtë sector të dënurit i meren të gjithë të dhënat e tij personale nga femirija e tij, me qëllim që të përcaktohet tretmani më adekuat ndaj tij gjithashtu njoftet edhe me rendin shtepiak në insitucion që me lehtë të adaptohet mbrenda.¹²⁶

Mirëpo duke u nisur nga këto regulla dhe ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale e vjen në shprehje menjëher mangesit në sistemin ton penitensiar.

në kohën e vizitits në burgun e Tetovës vërejtja shumë mangësi dhe dobsi në atë burg , elemente që ishin shumë larg asaj se cfar parasheh ligji Mbi ekzekutimin e sanksioneve penale , Rregullat standarde minimale të OKB-së apo rregullat Evropiane të burgut.

Edhe pse në vendin tonë , në sistemin penitensiar nuk ju është përkushtuar shumë rëndësi këtij sektori i cili është i rëndësishëm , më sakt ka vler të madhe sepse nëpërmjet këtij sektori bëhet edhe klasifikimi i të dënuarve në insitucion dhe shqipitimi i tretmanit të resocializimit, ku edhe qëllimi i shqipitimit të dënimit me burgim është risocilaizimi i tij i cili duhet të arihet në kohën e qëndrimit në insitucion .

E gjithë kjo arihet nëpërmjet ekspertëve të ndryshëm që duhet të jenë të punësuar në insitucionet penitensiar, e jo sic ishte gjendja në burgun e Tetovës.

Në atë burg ishin të punësuar vetëm një pedagog dhe një psikolog.

Por edhe pse këto janë paraparë si sektore nëvete , mirëpo në burgun e Tetovës është pak më ndryshe ato funksionon krejt bashkarisht për arsye të kushteve që posedonin si insitucion.

Mendoj se kushtete që ishin të ofruara nga ana e insitucionit nuk janë të mira dhe me ato kushte mendoj se nuk mund të arihet edhe i gjithë qëllimi apo obligimi që e ka qendra e pranimi , spse mendoj se mungonte ekipi profesionit në të.

Të gjithë këto kushte pamundësojnë risocilaizimin dhe riintegrimin e të dënuarve dhe aplikimin e mjeteve dhe metodave të avancuara ndaj të dënuarve .

Prandaj edhe duhet që tu mundësohen kushte më normale.

1.3. Vendosi e personave të dënuar

Ashtu sic janë të parapara shumë regulla me Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale

¹²⁶ Prof.Dr. Todor Krlev: Penoloshki Leksikon, Shkup 2002

ashtauëshët e paraparë edhe vendosja e personave të dënuar në ent.

Ku sipas ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale kjo rregull është paraparë në nenet 102-103.

Lokalet për vendosjen e persoanve të dënuar duhet t'i plotsojnë kushtet themelore higjenike dhe të jenë në përputhje me kushtet klimatike të mjedisit, të jenë të pajisura në mënyrë adekuate, ta mundësojnë ajrosjen e duhur dhe në ato të hujë dritë e mjaftueshme e ditës.

Neni 103 (1) lokalet në të cilat vendosen persoant e dënuar, nuk guxojnë të jenë me lagështi dhe për secilin person të dënuar mesatarisht duhet të sigurohet së paku 9 m³ hapsirë.

(2)'' Lokalet në të cilat qëndrojnë dhe punojnë perosnat e dënuar , doemos duhet t'i kenë instalimet e duhura sanitare dh higjenike dhe të sigurohen kushte tjera për mirëmbjatjen e higjenës personale, doemos duhet të jenë të ndricuara në mënyrë të mjaftueshme për punë dhe lexim , ashtau që personave të dënuar të mos u dëmtohet shikimi, dhe doemos duhet të jenë të ngrohta dhe të ajrosura.''

Personat e dënuar ne pajtem me mundësit e institucionit naten siazakonisht duhet të vendosen vetë, nëpër dhoma të vecanta, përvec në raste kur konisderoht se vendosja në dhomën e përbahskët është e dobishme.

Gjat vendosjes së disa personave në një lokal duhet të kënë parasysh gjithashtu edhe faktin se a u përshtaet shoqëria personave të dënuar.

Gjat vendosjes së të dënuarve në një lokal nuk duhet të klaoj më shumë se 5 veta , dhe të posedoj secili prej të dënuarve shtratin e vet.

Poshatu edhe nga vetë tëburgosurit kerkohet që të mbajnë pastërti e tyre dhe pastërtin e lokalit të tyre, me qëllim që të ruajnë ambientin e tyre dhe ruajatjen e shëndetit të tyre.

Regulla të cilat janë të parapa edhe me Rregullat evropiane të burgut .¹²⁷

1.3.1. Të drejtat e persoanve të dënuar në isnitucion

Duke shikur Kushtetuten , Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe Rregulloret e burgut vërehen edhe shumë të drjët të të burgosurve.

''Si të drjeta të të denuarve mund të përmenden :

¹²⁷ Ragip Halili : Penologjija E drejta Ekzekutimi të sanksioneve penale ; Prishtin 2014 fq 305

E drejta e punës, e drjeta e pushimit, e drjeta ne sigurimin social dhe ivalidor, e drjeta në arsim, e drejta në mbrojte shëndetësore , e drjeta në pranimin e vizitave, e drjeta e ankesës, kërkesës, e drjeta e pranimt të pakove etj.”

1.3.2.Të dhënat mbi numrin, moshën gjidhin veprat ekyrerar në burgun e Tetovës

Numri i të burgosurve	
2007	133persona
2008	163 persona
2009	158 persona
2010	123 persona
2011	137 persona
2012	117 persona
2013	119 persoan
2014	86 persona

Si vepra më të përsëritura për vitin 2007 - 2014 në Burgun e Tetovës janë

2007	Vjedhje	Vjedhe rëndë	Dhuna	Lëndime të rënda trupore	
2008	Dhuna	Vjedhje	Vjedhje rënd	Falsifikim i dokumenteve	
2009	Vjedhe e rëndë	Lëndime të rënda trupore	Falsifikim i dokumenteve	Dhuna	Vjedhje
2010	Vjedhje e rëndë	Vjedhje	Lëndim i rëndëtrupor	Trafikimi	
2011	Vjedhje e rëndë	Vjedhje	Dhuna	Falsifikimi lidokumenteve	

2012	Vjedhje të rënda	vjedhje	Keqpërdorim I të drejtës zgjedhore	Përpunim,mbajtje dhe tregtia e palejuar e armës apo materieve shpërthuese	Pengim i zgjedhjeve dhe I votimit
2013	Vjedhje e rëndë	Përpunim,mbajtje dhe tregtia e palejuar e armës apo materieve shpërthuese	Prodhim I paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve	Vjedhje	
2014	Vjedhje	Vjedhje e rëndë	Përpunim,mbajtje dhe tregtia e palejuar e armës apo materieve shpërthuese	Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve	

Burgu i Tetovës sizakonisht përbëhet prej personave të dënuar të gjinis mashkullore , nuk ka të dënuar të gjinis femrore. Duke e analizuar tabelen , vërejmë se veprat më të përsëritura në burgun e Tetovës janë sizakonisht , vjedhjet, vjedhjet e rënda, përdorim i substancave narkotike, dhe armëmbajtje pa leje, dhe nëkohën e zgjedhjeve parlamentare të vitin 2011 ka pasur një numër të vogël të personave që kanë kryer veprën keqpërdorim i të drjetës zgjedhore që e kanë kryer vetëm 3 persoan dhe ndalim i të drjetës zgjedhore vepër që është kryer vetëm nga 2 persona kjo është si rezultat i zgjedhjeve parlamentare të vitin 2011.

Verpa penale vjedhe , vjedhje e rëndë dhe përdorimi i substancave narkotike vërehet se janë më tëpërsëriutra në burgun e Tetovës si arsye të kësaj paraqitën rethanat apo kushtet e jetesës së popullatës në Maqedoni. Papunsia , krizat ekonomike sjellin deri tek këto vepra sizakonisht edhe joshkollimi tyre.

1.4. GJENDJA E BURGUT TË TETOVES

Burgu i Tetovës është burg i tipit gjysëm të hapur.

Dukë pasur parasysh tipin e burgut , kupojmë që në këtë burg mund të vuajnë dënimin vetëmë përsone me dënime afatshkurtë. Në këtë burg vujanë dënimin personat që janë ndeshur për herë të

parë më ligjin dhe të cilëve ju është shqiptuar dënim me burgim deri në 3 vjet, kurse persoant që llogariten si recidivist mund të vuajnë dënimin në burgun e Tetovës në qoftë se ju është shqiptuar dënim me burgim deri në 6 muaj , kurse për recidivistët ndaj të cilëve ju është shqiptuar dënim me burigm mbi 6 mujaj do të vujanë dënimin e tyr në burgun e Idrizovo.

Persoant që sizakonisht vuajnë dënimin në burgun e Tetovës janë ato persona të cilëve ju është shqiptuar dënimi , dënim me brugim në gjykatën e Tetovës dhe Gostivarit

Ashtu sic cdo burg edhe burgu i Tetovës posedon lokalet e vuajtjes së dinimit dhe paraburgimin, në paraburgim mund të vendosen personat ndaj të cilëve është parapa dënimi i vepres penale dëri ne 10 vite .

Persoant që qëndrojnë në paraburgim në këtë insitucion penitensiar gjithashtu nuk ju mohohet e drjeta e vizitës mjekësre , e drejta e vizitës familjare ,të drejtën e vzitës së advokatit të tyre d.m.th ndihmën juridike por për lejimin e kësaj venods gjykata e cila është kompetente.

Duke pasur parasysh faktin se burgu i Tetovës është burg i tipit gjysëm tëhapur , që kuptojmë se nuk e ka sigurin e lart dhe sizakonisht në këtë burg vuajnë dënimin persoant që nuk janë të rezikshëm për shoqërinë, dhe për këtë arsye ato kanë të drjëtë e punës qësizakonisht kanë punë jshtë insittucionitr nëpër firma private, të cilëve ju lejohet të dalin nga burgu prej ora 7 e mëngjesit dhe të paraqiten përsëri në burg në orën 5 të mbrëmjes.

Gjithashtu në burg brenda jantë të angazhuar të punojnë edhe të tjerët ku disa prej të burgosurve janë si kuzhinijer, disa janë të angazhuar per pastrimin e brugut , mbajtjen e regullsis së burgut ku kështu funksionojne cdo her me ndrim në cdo dy javë , d.m.th nuk i bëjnë punët ose nuk kanë obligimet e njeta në burg.

Që të vëretohet lloji i tretmanit që duhet të shqiptohet ndaj të dënuarve ,process i cili realizihet në qendërën e pranimit duhet që të reazlizohen disa parakuhste per tësic është:

- Autobiografija e të dënuarti
- Amneza kriminologjike
- Amenza sociale
- Vlersimi i shkallës së rizikshmëris

- Poashtu kontaktohen edhe gjykata që të meren informata të detajuara ndaj të dënuarit se a udhëhiqet edhe ndonjë procedur tjetër ndaj tij.

Si tretmane që shqiptohen sizakonisht janë :

- Tretmani i hapur
- trepamn gjysëm i hapur
- dhe tretman i mbyllur

Tretman i hapur është tretman që nuk mund të shqiptohet për secilin person të dënuar , por sizakonisht shqiptohet për personat që kanë kryer vepra penale më të lehta ndaj të cilëve ju është shqiptuar dënim me burgim deri në 1 vitë edhe të cilët për herë të parë ndeshen me ligjin dhe vuajnë dënimin në burg, ku edhe shkalla e rezikshmërisë se tyre është shumë e vogël.

Asnjëherë nuk ka ndodhur që personat që kanë tretman të tipit të hapur të kthehen përsëri në burg, sepse sizakonisht ato janë në burg për vepra të lehta.

Personat që kanë tretmanin e tipit të hapur, janë ata persoan të dënuar që kanë edhe më shumë privilegje sepse shkalla e rezikshmëris së tyre është shumë e vogël , kështu që atyre ju lejohet edhe të punojnë jashtë burgut nëpër firma private.

Në burgun e Tetovës sizakonisht shqiptohet tretmani i tipti të hapur dhe gjysëm i mbyllur, kurse tretmani i tiptit të mbyllur sizakonisht aplikohet ne burgun e Idrizovës për personat që kanë shume vepra penale të kryera dhe shkalla e rezikshmërisë është më e lartë., sizakonisht këta llogariten edhe si recidivist.

Nëse të dënuarit të cilët qëndrojnë në këtë burg , kryejnë ndonjë veper të re, nuk respektojnë rendin shtëpiak në burg,regullat disiplinore, krijojnë ndonjë bunt në burg atëher dërgohen në qelin e vetmis ku qëndrojnë për 15 dit , në qoftë së nuk përmissohet atëher qëndrimi në qelin e vetmis vazhdohet deri 30 ditë.

Si metoda që përdorën personeli i burgut ndaj të dënuarve në rugën e riedukuimit të tyre janë:

- Puna e persoanve të dënuar
- puna individuale e personelit të inistucionit me personate e dënuar
- puna grupore e personleit te inistucionit me personat e dënuar.

- vetorganizimi i personave të dënuar.

Metodat e bindjes dhe **metoda e këshillimit** janë metoda që realizohen më së shumti në mënyrë individuale, kurse metoda e grupeve nuk realizohet në këtë institucion për arsye se nuk ka kushte dmth, nuk ka personat adekuat për realizimin e kësaj metode.

Kurse si metoda që përdorin edukatorët në institucion ndaj të dënuarve janë:

- përdorim i metodës së bindjes,

- krijimin e shprehive

- metoda e nxitjes

- premtim i dhuratave dhe shpërblimeve në mënyrë publike

- shtërngim dhe ndëshkim ndaj tyre në qoftë se nuk respektojnë rendin shtëpiak.

Si cdo person i cili nuk është i dënuar edhe të dënuarit i kanë të gjithë të drejtata si ato që gjenden në liri, të dënuarit kanë të drejtën e ankesës mund të përdorin mjetete juridike, në burg egzistojnë edhe sektori juridik që u ofron ndihmë juridike të dënuarve, poashtu kanë të drejtë që të kenë edhe avokatin e tyre. Sizakonisht ato kanë ankesa deri te Avokati i Popullit, i cili i viziton shpesh të burgosurit për cdo ankesë që kanë.

Personave që ju është shqiptuar **tretmani i tipit të hapur** kanë të drejtën e shfrytëzimit të vikendit të lirë vetëm pasi që kanë kaluar 30 ditë nga mbajtja e dënimit, kurse personat që kanë të shqiptuar **tretmanin e tipit gjysëm të hapur** kanë të drejtën në shfrytëzimin e vikendit të lirë cdo 45 ditë.

Personat që janë në vujatje të dënimit për rreth 1 vitin kanë të drejtë në pushim vjetor për 20 ditë, kurse 15 ditë të vikendit.

Kurse secili i dënuar që është nën tretmanin e mbyllur ose ndryshe i quajtur V tretman nuk kanë të drejtën në pushimin vjetor.

Tretmani i mbyllur ose V tretmani ka tre grupe:

V1 : tretman i cili shqiptohet ndaj të dënuarve që janë në vujatje të dënimit në burgun e Idrizovës,

burg afatgjat

V 2 : tretman i cili shqiptohet ndaj të dënuarve që janë në vuajtje të dënimit me burgim me afat më shumë se 3 vjet, dhe ndaj tyre udhëhiqet edhe ndonjë procedur tjetër.

V 3 : tretman i cili shqiptohet ndaj të dënuarve që janë në vuajtje të dënimit me burgim në afat deri 6 vite dhe ndaj të cilëve nuk udhëhiqet ndonjë procedur tjetër, dhe mund të shfrytëzojnë vikend pushimin cdo 60 ditë.

Edhe nga vetë tretmani kuptojmë se këta janë persoan më të rezikshëm për shoqërin , ndaj të cilëve nevojitet kujdes me i vecant për arrijtjen e risozializimit sepse edhe rezikshmëria është me e madhe.

V3 : tretman i cili përdoret edhe në burgun e Tetovës , rastet e përdorimit të këtij tretmani vijnë në shprehje atëher kur personat që janë në vuajtje të dënimit në burgun e Idrizovës, dhe pas një kohe i sjellin në burgun e Tetovës, gjë që në këto burg nuk mund që tua ndrojnë tretmanin dhe vazhdon me përdorimin e tretmanit të më parshëm, edhe pse personi i cili gjendet në vuajtje e dënimit mund të të këtë sjelleje të mirë, ose vërehen ndryshime tek ai se procesi i risocilaizimit ka aritje përsëri nuk mund të ndrohët tretmani deri sa të arrij afatin kohor i cili është i paraparë me ligj.

Personat që janë në vuajtje të dënimit në këtë burg nuk obligohen që të punojnë, sepse nuk mund që të impnojnë punën , por vetem nëse ato dëshirojnë, kuptohet edhe nuk mundet të kenë benificonet si të tjerët , nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën e pushimeve si të tjerët që janë më aktiv.

Burgu i Tetovës posedon edhe libra të ndryshëm me tematika tëndryshme , pas drekës të dënuart kanë të drejtë në aktivitete sportive përeth 2 orë.

Shpesh ndodh që të kenë mosmarveshje të burgosurit mes vetë, edhe për këtë arsye egziston edhe dhoma e vetmis, në vetmi qëndrojnë prej 15 deri 30 dit varësisht prej veprës së bërë.

Që i dënuari gjat vuajtjes së dënimit për të u futurë në qelin e vetmis propozon komisioni, për këtë e venos drejtori i burgut pas konstatimit të rethanave rreth veprës së bërë ose shkeljes disiplinore.

Nëse shqiptohet , nga ana e komisionit qëndrim në qelin e vetmis 30 ditë atëher ajo llogaritet si veper e re penale. P.sh.nëse vjedh dicka brenda qelis, edhe ankohet ndonjëri prej të burgosurve se është vjedhur dicka, pas vertetitmi të rethanave që egziston vjedhje brenda qelisë, atëher kjo llogaritet si veper e re penale , vjedhje që denoncohet në polici.

Komisioni i cili formohet në burg ajo formohet nga ana e drejtorit i cili përbëhet prej 3 antarëve 1 është kryetar dhe 2 të tjerë janë nga sekot tjerë.

Reformat e nevojshme në burgun e Tetovës

Burgu i Tetovës, ashtu edhe si cdo insitucion penitensiar në Maqedoni ka magësit e veta brenda , ku në këtë rast shprehen edhe pengesa e nevojave , apo të drejtave që u takjonë të burgosurve të cilat garantohen me Kushtetutë, akte nenligjire, konveta ndërkombetare etj.

Edhe pse në burgun e Teovës nuk janë të privuar persoant që kanë kohëzgjatjen e dënimit shumë të gjatë, por në këtë burg janë të vendosur personat e dënuar me denime afat shkurtederi në tre vite, vetëm në raste të caktuara në qoftë se është pararë më ligj mund të vujanë dënimin persona me dënim më shumë së tri vite.

Sipas deklarimeve nga ana e të dënuarve nuk kishin edhe shumë ankesa apo vërejtje , por rethanat që ishin në atë burg mund të them së kisht shumë mangësi ai insitucion.

Sipas disa të burgosur, pohojshin se ditën e pranimit në këtë insitucion respektohen të gjitha rregullat të cilat janë edhe të parapa me ligj , d.m.th ato qëndrojnë në qendren e pranimit aq koh sa që edhe parasheh ligji dhe trajtohen në atë mënyre që edhe është e paraparë me ligj, me qëllim të aplikimit të tretmanit më adekuat për ato si të dënuar.

Edhe nga ana e të dënuarve nuk kishte ankesa në aspektine pranis të pedagogut apo psikologut, sepse ato ishin cdo herë të pranishim në insitucion.

Por duhet të ceket edhe ajo se burgu i Tetovës si insitucion penitensir, nuk kishte edhe kushte të mjaftueshme sic duhet, sepse ishte i përbere prej dy kateve d.m.th në katin përdhes ishin të vendosura lokalet e paraburgimit , kurse në katin tjetër , ishin pjesa e qelive, zyra e pranimit ku në një zyrë kishte shume sektore. Në një zyrë ku kryhej pranimi i të dënuarve qëndronin , jurisiti i të dënuarve, pedagogu apo sociologu i burgut. Ishtë një zyrë e vogël në të cilën kishte me shumë se 3 tëpunuar ,ku mendoj se nuk kishte kushte të mjaftueshme që të meret në pyetje të dënuarit , sepse marja në pyetje apo qëndrimi në qendrën e pranimit bëhej në prani të më shumë persoanve, kjo ndodhte sepse edhe nuk kishte shumë hapsir në atë qendër. Mu për këtë arsye mendoj se nuk është

zgjdhje e mir kjo situatë që ishte e pranishme në entin e Tetovës , sepse personat e privuar nga liria në momentin që dërgohen në qendër pranimi duhet që në mënyr të detajuar të studiohen si persona , apo si karakter. Duhet që në mënyr të detajuar të tregojnë gjithcka rreth tyre , për arsye se nga kjo edhe nvarët shumë tretmani i cili do të shqiptohet ndaj tyre me qëllim të aritjes së risocializimit , ku edhe arsytja e enteve ndëshkuese-korektuese është risocializimi i tyre që në të ardhmen kur të kthehen në liri të rrespektojnë rregullat ligjore , apo morale. Për aritjen e kësaj i dënuari duhet që të fitoj besim tek të punsuarit në ent që të ketë më lehtë të rrëfëhet.

Poashtu personat që vuanin dënimin në këtë burg nuk kishin edhe shumë ankësuar përpara u përket lokalve në të cilin qëndronin , apo qelija në të cilin qëndrojnë.

Kurse sa i përket anës ushqimore, edhe në këtë aspekt nuk kishte ankësuar , edhe pse ato përgatisnin vet ushqimet në kuzhinën e burgut , sipas pohimeve të tyre nuk kishin mundësi të ushqimit, respektoheheshin rregullat ushqimore tre herë në ditë për çdo të dënuar.

Edhe pse respektoheheshin rregullat mjeksore, apo vizitat mjeksore në këtë burg, por mjek të përhershëm në këtë institucion nuk kishte .Në këtë institucion vizita mjeksore bëheshin nga ana e mjekut të qytetit i cili ishte i paraparë të vizitonte të burgosurit.

Por ishte e pranishme një motër medicinale e cila kujdesej për të burgosurit., edhe sa i përket barnave që përdornin në ent nuk kishin ankësuar në këtë aspekt. Edhe pse unë isha prezente në një rast , kur një nga të dënuarit kërkonte medikamente sepse kishte nvarshmëri nga narkotikët dhe po kalonte krizë nervore ku kërkonte qetësues , por motra medicinale e cila ishte e pranishme në burg I tha nëse dëshiron mund që ti blej vet sepse nuk kishte qetësues.

Si mangësi që vërehej në këtë burg ishte se nuk kishte hapësirë të vecnat për takimet familjare, të drejtë që nuk ju mohohete të dënuarve, sepse atyre u mundësohej takimi me familjarët ashtu sic është edhe e paraparë në ligj. Poashtu edhe nga ana e vet të dënuarve nuk kishte ankësuar në këtë aspekt ,sepse ato kishin vizita të rregullta nga ana e familjarve , kuptohet ashtu sic është edhe e paraprë me ligj. Por si mangësi në këtë aspekt ishte se vizita familjare mbahej në oborin e burgut sepse nuk kishin vend të posaçem për takime familjare.

Sizakonishtë vizita familjare mbaheheshin një herë në tre javë.

Kurse për ndihmat juridike apo takime me advokatatët e tyre kishin të drejtë të mbajnë takim çdo ditë

prej ora 8 30 deri ora 16 pas dite, e drejt që nuk i mohojes as të burgosurve , e as atyre që qëndronin në paraburgim.

Për përmisim të tëdënuarve ,është shumë e rëndësishme të mbahen apo te respektohet regullat e aktiviteteve të ndryshme ndaj të dënuarve, elementet i cili është i paraparë edhe me ligjin mbi ekezkutimine sanksioneve penale . Aplikimi i metodave ndaj të dënuarve ndikon edhe tek tretmani i tyre. Sipas persoanve të dënuar nuk ishin te gjidhë të kënaqur në këtë aspekt, sepse pohonin se nuk organizoheshin aq sa duhet aktivitetet sportive në institucione, dhe nuk kane kushte të llojit të till të otganizimit të aktivitetve sportive. Edhe pse të punuarit të atëinstitucion mohonin këto ankesa sepse shpreheshin se në ent organizoheshin aktivitete sportive cdo dit pas mbarimit të drekes. Eshte e nevojshme që të aplikohen metoda të llojit të tij sepse ato bëjnë pjesë në tretmanin e të dënuarve .

Në këtë insitucion , gjithashtu ështëi pranishëm edhe sektori i sigurimit , i cili ështëi paraparë edhe me ligj që është i pranishëm në insitucion 24h me ndrime. Gjatë bisedave me të dënuarit pohonin se nuk ju është ushtrur dhunë nga ana e personelit të sigurimit.

Ndërsa disa prej tyre ankohësh nga ana e personelit të sigurtimit , se ju është nënshtruar dhunë. Por në momentin e takimit me sektorin e sigurimit ato gjithnjë pohojshin se nuk ushtrojnë asnjëherë dhunë ndaj të dënuarve , nga vetë fakti se personat që janë të dënuar në këtë burg shakllen e rrezikshëmrisë e kane të ulet dhe nuk jan persona të rrezikshmën.

Gjatë qëndrimit në ente të dënuarit kanë të drejtën e shkollimit, ku pas marjes së diplomave nuk ju shënohet që e kanë kryer prej në burg shkollën po certifikatat do të meren njejte si persoant që nuk janë ne vuajtje të dënimit.

këtë të drejtë e kanë të paraparë edhe me ligj të dënuarit në insitucion, poashtu këtëe pohonin edhe të dënuarit se ju lejohet shkollimi në insitucion, se gjithashtu kanë edhe bibliotekën ne burg por nuk e shfrytëzojnë aq edhe sa duhet, sepse në bibliotek kishte munges të librave në gjuhën shqipe. Por edhe nga ana e të dënuarve nuk kishin edhe shum intereseim që te lexonin libra.

Personat e dënuar që vuanin dënimin në këtë burg më shum kishtë persona me shkoll të mesme, edhe me shkollë fillore.

Disa prej tyre pohonin se gjatë kryerjes se veprës së tyre penale, dhe gjatë vuajtjes së dënimit kanë ndryshuar edhe raportet familjere të tyre dmth disa që kanë qenë të martuar gjatë vuajtjes së dënimit

jane divorcuar.

Por tek disa statusi martesor ka qëndruar i njejt.

Gjithashtu ka pasur edhe shkëputje familjare pas mbarimit të dënimit me burgim , për arsye se janë shikur me një sy krejtsish ndryshe , jo sic kish qenë më para se të privohen. Që nënkupton se edhe pse dënimi me burgim dhe qëndrimi nëpr bugje ka edhe vetit e veta pozitive që si qëllim të vetëm kanë risocilazimin e të dënuarve , por tek disa mund të ndikoj edhe negativisht sepse jeta pas burgut ndryshon. Për këtë arsye ëshë e nevojshë edhe ndihma post penale e personave të dënuar pas mbariit të dënimit me burgim. Ku me këtë kuptojme se e gjith procesi I personave të dënuar nuk mbaron vetem me shqipitimet e tretmanve apo tq qenurit të izoluar në burg , po e rëndësishme është edhe jeta e tyre pasi që të mbarojnë vujatjen e dënimit. Ku nodh që të hasen në problem të shumta , nga papunsa , mosstrehimi , shkëputjet e tyre me familjen, poashtu edhe gjendja psikologjike e të dënuarit.Këto problem që paraqiten sizakonisht , cojn edhe deri tek kthimi I rugëve të më parshme kriminale. Për këtë arye pas mbarimit të tretmanit pergjat vujatjes së dënimit të vij në shprehje edhe ndihma post penale. Që nënkupton se puna e insitucionit penitensiar me të dënuarit nuk ka mbaruar ende , ku kjo ndihmë duhet që të vij në shprehje edhe në kohën e të qënurit në burg , qe nënkupton se kjo duhet të meret nga ana e pedagogut , psikologut , persoanve që janë të punusar në ent që të pregadisin të dënuarin për kthiimin e tyre në liri , është e rëndësishim pas daljes nga burgu gjendja e strehimit të tyre , gjetja epunës me një fjalë ndihm për të që mos hasin në problem me mos adaptimin në liri , dhe kthimin në gjendje të më parshme.

Pëfundimi

Duke shikuar historikisht dënimet , me sakt shqiptimin e dënimit me burgim –si dënim ndaj kryerësve të veprave penale , apo kriminelëve ka kaluar nëpër disa faza të ndryshme duke u nisur nga periudha e gjakmarjes dhe hakmarjes e deri në kohën modern ka kaluar në faza të ndryshme. Në fillim shqipitmi i dënimit me burgim ka pasur një karakter apo një rol krejtësisht të kundërt me atë që e ka në ditën e sotit. I gjithë qëllimi i ekzekutimit të dënimit me burgim isht hakmarja ndaj të dënuarve , duke u shprehur me anë të torutrave të ndryshme , poshtëtimeve, edhe pse manifestoheshin dëimet në mënyra të vrazhda përsëri ky lloj dënimi nuk pati sukses për parandalimin e kriminalitetit.

Këto llojet e vrazhda të dënimeve apo ekzekutimit të dënimi me burgim në kohën modern kanë ndryshuar në masë të madhe , ku në ditën e sotit qëllimi i dënimit , apo shqiptimi i dënimit me burgim , si dënim ndaj kryerësve të vepra e penale, është risocilaizmin i tyre dhe kthimi i të dënuarve ne shoqëri të përmisuar dhe të vetëdëshme se duhet të respektohen normat shoqërore. Poashtu hasim edhe ndryshim të institucioneve penitensiare , ku në kohën e hakmarjes si burgje përdorehiin , kështjellat , apo bodrumet, kalat e nryshme . Kurse sot insitucionet penitensiare – janë krejtësisht të ndryshme .

Këtë mund ta haspim gjithashtu edhe tek Kushtetatura e RM-së e cila garanton se qytetarët e RM-së janë të barabarte ne lirt dhe të drejtat pavarësisht ngja gjinija , raca. Gjyra e lekurës . prejardhaj kombëtrae dhe sociale , bindjet politike dhe fetare.

Poashtu e kemi edhe Ligjin për Ekzekutimi e Sanksioneve penale i cili granton panshmërin dhe barazin ndjat te gjith të denuarve pa dallime. Kur jemi në këtë fushë insitucionet ndëshkuese korrektuese u mundësojne të dënuarve u mundësojne të gjithë të drjetat e tyre ku kantë të drjetën e shkollimit , te drjetën e vizitave familjare apo garantimin e ndihmës juridike , ndalimin e cdo lloj torure ndaj tyre , ku me antë të ketyre regullave mud të shohim se edhe insitucionete tona penitensiare po ndjekin te gjith elementet e insitucioneve penitensiare modern .

Sa i përket aspektit të torturimeve, malltetimeve , poshtëtimeve nga ana e personaelit gjithashtu nuk egziston , sepse në këtë burg sizakonisht qëndrojnë persnat që shkallen e

rezikshmërisë e kanë të ulur dhe nuk janë zgresiv .

BIBLIOGRAFIA

- 1.Ragip Halili ‘’Penologjija’’Prishtinë 2014
- 2.Ejup Sahiti ‘’Psikologjia Gjyqësore’’2007
- 3.Vllado Kambovski’’ E drejta penale pjesa e përgjithshme’’Shkup 2007
- 4.pravda.gov.mk
- 5.Mitasin Beqiri ‘’Organizimi dhe gjendja e institucioneve penitensiare në republikën e maqedonisë’’ Tetovë 2007
- 6.Afrim Osmani ‘’Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve’’Shkup
7. Ligji I procedurës penale (Gazaeta zyrtare e RM- së ‘’ nr. 15/97, 44/2002, 74/2004, 83/2008 и 67/2009). <http://ëëë.pravo.org.mk> e qasur
8. Prof.Dr. Todor Krlev: Penoloshki Leksikon, Shkup 2002
- 9Lupco Arnaudovski: Zatvorenicko Opshtestvo, Shkup, 2000
- 10.https://hr.ëikipedia.org/ëiki/Smrtna_kazna

11. http://ëëë.mojrad.net/pregled_teksta.php?id=6371LScCNBSëgai6LsE5dgnVLScCNBSëgai6LsE5dgnV
12. R. Gashi: Ekzekutimi I dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë 2001
13. <http://tsr.pravo.unizg.hr/materijali/PENOLOGIJA.pdf> e qasuar
14. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale , ‘‘ Gazeta Zyrtare e RM-Së’’ nr. 2/2006, 57/10, 170/13, 43/14, 166/14, 33/15
15. <http://ëëë.pravo.org.mk>
16. <https://zir.nsk.hr/islandora/object/unipu%3A646/datastream/PDF/vieë>
17. <http://telegrafi.com/te-drejtat-dhe-lirite-e-njeriut/>
http://ëëë.mojrad.net/pregled_teksta.php?id=6371LScCNBSëgai6LsE5dgnVLScCNBSëgai6LsE5dgnV
18. Dr. Dragomir Davidovic, Olgica Matic, Branko Vukadinovic I Branimir V: Kategorizacija Kazenono* Popravni Domova I klasifikacija osudjeni lica u Jugoslavij , Beograd 1970
19. <http://ombudsman.mk/upload/documents/Poseta%20na%20zatvori-alb.pdf> Raportete e vecanta, Advokati I Popullit 2006.
20. <https://ëëë.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nsp> e qasur
21. <http://ëëë.hracion.org/ëp-content/uploads/Evropska-zatvorska-pravila.pdf>
22. Doc. Dr. Afrim Osmani / Kodi Penalë i RM –së Shkup , 2010
23. Të dhëna të marura nga Burgu i Tetovës
24. Biseda me pedagogun dhe psikologun e burgut.